



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

“Menaxhimi i terreneve sportive”



TIRANË, SHTATOR 2022

PËRMBLEDHJE

1.PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT	4
<u>1.1 Konteksti i problemit social</u>	4
Roli pozitiv i të bërit sport në shkolla si dhe marrja me sport e shoqërisë.	4
<u>1.2 Rëndësia e auditimit të performancës</u>	4
<u>1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë</u>	6
SUBJEKTET NËN AUDITIM	7
<u>2.1 Hyrje në subjektet nën auditim</u>	7
<u>2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim</u>	9
<u>2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit</u>	10
<u>2.4 Pesha në buxhet</u>	11
<u>2.5 Feedback-u i subjektit gjatë auditimit</u>	18
3. DETAJET E AUDITIMIT	18
<u>3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit</u>	18
<u>3.2 Objektivi i auditimit</u>	20
<u>3.3 Pyetjet e auditimit</u>	21
<u>3.4 Fushëveprimi i auditimit</u>	22
4. SHTJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE	22
<u>4.1.1 A janë hartuar dhe miratuar strategji kombëtare për sportin ose dokumenta të tjerë politikë për zhvillimin e sportit?</u>	23
<u>4.1.2 Si ka qenë niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit mes aktorëve në politikat e hartuara e të zbatuara?</u>	25
<u>4.2.1 A janë marrë masa për ngritjen e strukturave të përshtatshme në nivel qendror të cilat përmbushin nevojat për menaxhimin e terreneve sportive?</u>	27
<u>4.2.2 A ekzistojnë strukturat e nevojshme dhe të përshtatshme në NJVQV për menaxhimin e terreneve sportive?</u>	30
<u>4.3.1 A ka qenë e mjaftueshme mbështetja financiare nga fondet buxhetore për ofrimin e logjistikës dhe infrastrukturës së duhur për terrenet sportive ?</u>	34
<u>4.3.2 A janë përdorur nga ana e NJVQV burime të tjera të financimit në funksion të terreneve sportive?</u>	44
5. PËRMBLEDHJE	46
6 . GRUPI I PUNËS	46

LISTA E SHKURTIMEVE

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
KLS	Këshilli i Lartë i Sportit
NJVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
FK	Futboll Klub
KES	Karta Evropiane e Sportit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (<i>The International Organisation of Supreme Audit Institutions</i>)
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SKA	Strategjia Kombëtare e Arsimit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (<i>International Standards of Supreme Audit Institutions</i>)
3E	Ekonomiciteti, Eficienca, Efektiviteti
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit të Bashkisë
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT

1.1 Konteksti i problemit social

Sporti, pa dyshim në të gjitha aspektet e ekzistencës dhe zhvillimit të tij, është elementi më i pranishëm në jetën e njerëzve, është argëtimi kryesor për të gjithë pjesëtarët e familjes, evenimenti më interesant për mediat, biznesin dhe politikën. Shoqëria njerëzore ka hyrë kështu në epokën e sportit dhe me siguri do të qëndrojë gjatë në të.

Sporti dhe kultura janë imazhi i parë i një vendi dhe me sport e kulturë njihen ndërkombëtarisht më mirë tiparet e tij. Vlerat e sportit janë si të rrafshit kombëtar, ashtu dhe ndërkombëtar. Në Shqipëri, kalimi nga sistemi komunist në sistemin demokratik u shoqërua me ndryshime që përveç të tjerave ndikuan edhe zhvillimin e sportit. Duket sikur sporti pas rënies së komunizmit, vuan nga politikat shterpë të shtetit, të ndërkombëtarësh gjitha qeverive. Nga gjendja ku ndodhet aktualisht sporti, të krijon bindjen se ky sektor nuk është parë asnjëherë si prioritet. Natyrisht, janë shumë faktorë që ndikojnë negativisht në këtë situatë të vështirë të sportit, por kryesorët lidhen me mungesën e vëmendjes nga institucionet publike; Mungesën e strategjive për sportin; Mungesë e investimeve në infrastrukturën sportive, e cila nuk plotëson as kushtet më minimale për zhvillimin e veprimtarive; Financime të pakta të sporteve individuale dhe kolektive, të cilat megjithëse të pakta përsëri abuzohet me ato; Mungesë e bazës materiale (komplete sportive, topa, tapet, uniforma zyrtare për ndeshje) dhe të produkteve mjekësore (vitamina) etj.

Roli pozitiv i të bërit sport në shkolla si dhe marrja me sport e shoqërisë.

Përfshirja e sportit në shkolla është një mundësi e mirë për të rinjtë që të rriten të shëndetshëm. Sporti përmirëson jetën. Është shumë e rëndësishme të kuptohet që fëmijët duhet ta vlerësojnë rëndësinë e aktivitetit fizik që në moshë të re.

Sporti përcaktohet sot si mjeti më efikas i edukimit, argëtimi dhe parandalimit të sëmundjeve, zhvillimit të identitetit kombëtar, forcimit të marrëdhënieve sociale dhe eliminimit të faktorëve negativ shëndetësorë e socialë të zhvillimit të fëmijëve, alternativë, e shëndetshme për kohën e lirë të rinisë, mundësi punësimi dhe degë e rëndësishme e ekonomisë kombëtar për një moshë të trete aktiveje produktive dhe ndërkombëtare, “ilaçi” më i mirë.

Ky auditim mund të shërbejë më së miri për dhënien e disa rekomandimeve në ndihmë të zhvillimit të sportit duke siguruar kështu politika funksionale në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës sportive dhe në veçanti të terreneve sportive dhe nivelit të pjesëmarrjes së shoqërisë duke rritur dhe financimet në fushën e sportit, e në veçanti për terrenet sportive..

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës


Auditimi në vetvete është një instrument thelbësor i procesit të llogaridhënies për shpenzimin e parave publike, duke dhënë kështu një kontribut të rëndësishëm për miradministrimin e burimeve dhe kryerjen e shërbimeve për qytetarët. Ndërsa nëpërmjet auditimit të performancës bëhet një shqyrtim i pavarur për të kuptuar nëse angazhimet qeveritare, operacionet, programet, aktivitetet apo institucionet e saj janë duke vepruar në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit dhe nëse ka vend për përmirësim, në aktivitetin e tyre, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditon midis të tjerave veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë publikë, për të evidentuar nëse aktiviteti i tyre ka rezultuar me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet, duke rekomanduar masat e duhura për përmirësimin e performancës së tyre.

KLSH nëpërmjet auditimit bën transparente përdorimin e fondeve publike, administrimin e pronës publike dhe ligjshmërinë e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, procedural legalizimet, kryerjen në kohë e me cilësi dhe kosto optimale të shërbimeve publike, etj¹ Kryerja e auditimeve në përgjithësi dhe atyre të performancës në veçanti nga KLSH, bëhet në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe me objektivat e Strategjisë për Zhvillim të EUROSAI 2017-2023. Sipas kësaj Strategjie, KLSH ka për objektiv rritjen e cilësisë së auditimit dhe shtimin e numrit të auditimeve të performancës, nëpërmjet Audituesve të përgatitur dhe të mirë-trajnuar. Tematika e auditimeve të performancës nis me përzgjedhjen e propozimeve për auditim që në vitin paraardhës, në zbatim të Manualit të Auditimit të Departamentit të Performancës, i miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 78, datë 30.06.2020²

Ky auditim ka në fokus kryesisht Menaxhimi i Terreneve Sportive në Shqipëri, në drejtim të efektivitetit të politikave dhe rregulloreve kryesore të terreneve sportive.

Nëpërmjet këtij auditimi, KLSH synon të vlerësojë performancën e veprimtarisë së MAS dhe NJPV (*kapaciteteve dhe burimeve të strukturave të përfshira*) në nivel vendor dhe qendror i cili realizohet nëpërmjet;

Struktura e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit dhe Sportit në Ministrinë e Arsimit, Sportit



¹ Neni 6 i Ligjit nr. 154/2014 "Per organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

² Manuali i Auditimit të Performancës.

Bazuar në sa më sipër, ky lloj auditimi ka si synim të rekomandojë korrektime të duhura, për ngritjen dhe administrimin sa më të mirë të terreneve sportive në shkollë dhe sa i shërben komunitetit në përgjithësi, bazuar mbi rritjen e përgjegjshmërisë, kapaciteteve dhe shpërndarjes së terreneve s

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficiencia dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit. Në linjë me prioritetet e përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022 për auditimet e performancës, si: *fokusimi në çështje makro-ekonomike, krahas atyre mikro-ekonomike apo fokusimi në auditime procesi më shumë sesa auditime institucioni*³, etj., KLSH ndërmori auditimin ”Menaxhimi i terreneve sportive në MAS dhe në NJVQV”, duke konsideruar mjedisin si një ndër çështjet dhe problematikat me të cilat shoqëria përballlet çdo ditë. KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale në lidhje me politikat mjedisore dhe efektivitetin e tyre, si dhe të japë rekomandime për të përmirësuar situatën aty ku është e mundur.

1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë

Auditimet e performancës që janë kryer gjatë viteve të fundit nga KLSH kanë pasur një rritje të konsiderueshme në numër dhe në cilësi. Bazuar në të dhëat e veprimtarisë Audituesetë Departamentit të performancës në KLSH, konstatohet se në periudhën viti 2017- 2018 janë kryer tre auditime në lidhje me politikat e ndjekura nga institucionet përkatëse për sportin dhe në veçanti menaxhimin e terreneve sportive si më poshtë vijon:

- ✓ Performanca e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në zhvillimin e sportit”, referuar vendimit të Kryetarit të KLSH-së me nr.200, datë 29.12.2017.Gjatë këtij auditimi është arritur në këtë mesazh se “ Gjendja aktuale e sportit në Shqipëri vuan mungesën e vizionit dhe jo efektivitetin e politikave për zhvillimin e tij nga ana e qeverive të ndryshme dhe Ministrisë përkatëse, fondet e pakt të akorduara çdo vit në favot të tij nga buxheti i shtetit , si një jo eficiensë në përdorimin e burimeve të ndryshme të fondeve për sportin”
- ✓ Financimi i Klubeve Shumë-Sportesh”, referuar Vendimit të Kryetarit të KLSH-së me nr.226. datë 21.12.2018, në përfundim të auditimit u arrit në këtë mesazh se ; “Gjendja aktuale e sportit në Shqipëri vuan mungesën e vizionit dhe joefektivitetin e politikave për zhvillimin e tij nga ana e qeverive të ndryshme dhe Ministrisë përkatëse, fondet e pakta të

³ Strategjia e Zhvillimit Institucional 2018-2022 KLSH, fq. 39

akorduara çdo vit në favor të tij nga Buxheti i Shtetit, si dhe joeficiencën në përdorimin e burimeve të ndryshme të fondeve për sportin”.

- ✓ Parqet rekreative në Tiranë - Këndet e lojrave, referuar vendimit të Kryetarit të KLSH-së me nr.225, datë 20.12.2018, në përfundim të auditimit u arrit në këtë mesazh: “Aktiviteti i institucioneve përgjegjëse për administrimin e parqeve rekreative në qytetin e Tiranës për periudhën objekt auditimi nuk ka qenë efikas në disa aspekte. Kjo pasi Bashkia Tiranë dhe APR nuk kanë ende të miratuar një Plan Strategjik institucional dhe Standarte për projektimin dhe mirëmbajtjen e tyre”.

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjektet që do të përfshihen në këtë auditim janë:

Ministria e Arsimit dhe Sportit

Bashkia Librazhd

Bashkia Pogradec

Bashkia Prrenjas

Bashkia Kurbin

Në fushën e sportit ligji që përcakton kompetencat e institucioneve qendrore dhe vendore, mënyrën e organizimit, financimin si dhe marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet organizatave sportive dhe këtyre institucioneve është Ligji nr.79/2017, datë 27.04.2017 “Për Sportin”, i ndryshuar, i cili përcakton se shteti zhvillon sportin për të gjithë dhe mbështet pjesëmarrjen e shtetasve në sport, nëpërmjet krijimit të kushteve ligjore, financiare dhe të infrastrukturës sportive.

Institucioni publik në nivel qendror, përgjegjësi kryesor për hartimin dhe zbatimin e politikës shtetërore, plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e sportit, si dhe administrimin dhe kontrollin e përdorimit të fondeve buxhetore për sportin nga organizatat sportive, është Ministria e Arsimit dhe Sportit .⁴

Në nivelin lokal, institucioni publik i cili ka përgjegjësi për hartimin dhe garantimin e politikave vendore, strategjive përkatëse, krijimin e institucionit përgjegjës në fushën e sportit, menaxhimin e objekteve sportive që ka në pronësi si dhe mbështetjen e veprimtarive të organizatave sportive, është njësia administrative e pushtetit vendor. Këto detyrime për institucionet e dy niveleve (qendror dhe lokal), nuk ndryshojnë edhe në Ligjin e ri të sportit.⁵ Gjithashtu në të dy Ligjet e sportit parashikohet krijimi i disa strukturave mbështetëse për sportin në varësi të MASR, të cilat kanë ndryshime në emërtimin e tyre dhe pak në funksionet që kryejnë, por grupi i auditimit e gjykoi të arsyeshme të pasqyrojë atë që duhet të ketë ndikim në objektin e auditimit, konkretisht:

Këshilli Kombëtar i Sportit, aktualisht Këshilli i Lartë i Sportit, i cili është organ këshillimor, për hartimin dhe zhvillimin e politikave për sportin. pranë MASR;

Në Ligjin 79/2017 neni 30 kreu VI –Infrastruktura Sportive, neni 30-Objekte sportive përcaktohet se janë publike ose private, sipas juridiksionit të tyre dhe janë në pronësi të pushtetit qendror ose

⁴ Ligji nr. 79/2017 27.04.2017 “Për Sportin”, i ndryshuar, neni 7 dhe 8.

⁵ Ligji nr. 79/2017 Për Sportin, neni 7 dhe 8.

vendor. Ata janë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e tyre. Objektet sportive ngrihen dhe mirëmbahen për krijimin e kushteve për ushtrimin e veprimtarive sportive.

Në nenin 31 të ligjit nr.79/2017 datë 27.04.2017 -Ndërtimi i objekteve sportive ndërtohen në përputhje me standartete dhe kushtet teknike të miratuara nga federatat ndërkombëtare të sportit përkatës.

Në nenin 33, të ligjit nr.79/2017, datë 27.04.2017-Shfrytëzimi i objekteve sportive , është e drejtë e personit fizik apo juridik që ka në administrim objekti sportiv apo kujt do tjetër të cilit ky i fundit i jep të drejtën e shfrytëzimit.

Niveli qendror për sportin:

Në MAS struktura përgjegjëse për sportin gjatë periudhës nën auditim bazohet në Urdhërin e Kryeministrit nr.163, datë 05.10.2017, ishte e organizuar në tre sektorë dhe me Urdhërin e Kryeministrit me nr.144, datë 16.12.2021 struktura për sportin u rroganizua në Drejtori me dy sektorë. Kjo drejtori ndahet në dy sektor, ku një prej tyre ishte dhe sektori i politikave për zhvillimin e sportit shkollor dhe universitar dhe i zhvillimit të sportit elitare, me mision kryesor zbatimin e politikës shtetërore në sportin elitare. Sipas viteve objekt auditimi struktura e organizimit paraqitet si më poshtë vijon:

Organizimi në nivel vendor

Ligji 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore në fushën e mbrojtjes së mjedisit në nivel vendor rregullon organizimin dhe funksionimin e Njërive të Vetëqeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse, si më poshtë:

- Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore krijojnë struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi⁶;
- Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversita (pika11).


Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

- ✓ Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve (Pika 4 e nenit 25 “Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese”).⁷;
- ✓ Garantimin e kushteve të sigurisë së jetës dhe të shëndetit publik, rendit publik dhe sigurisë kombëtare;
- ✓ Të nxitin veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, zonave të mbrojtura, monumenteve të natyrës, zonave të ndjeshme mjedisore dhe të peizazhit;

⁶ Ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 9 "të drejtat dhe përgjegjësitë"

⁷ Ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 26 "Funksionet e bashkive në fushën e sportit"

Autoritetet përgjegjëse për planifikimin e territorit në nivel bashkie janë këshilli bashkiak dhe kryetari i bashkisë.



2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

- Ligji Nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 79/2017 “Për sportin”;
- Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 ”Për pronat e paluajtshme të shtetit”;
- Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 ”Për transferimin e pronave të pa luajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;
- Ligji 115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 68, datë 15.02.2001 “Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 74, datë 27.1.2016 “Për miratimin e planit kombëtar për integrimin evropian 2016–2020”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.11, datë 11.1.2016 “Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të arsimit para universitar, për periudhën 2014–2020” i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 13.9.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ” i ndryshuar;
- Vendimin i Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 29.3.2018 “Për Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike”;
- Vendimin i Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 29.01.2020 për një ndryshim në VKM nr. 319, datë 12.04.2017 “Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 523, datë 22.09.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.621, datë 22.10.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsim 2021-2026;
- Urdhri i Kryeministrit nr.163, datë 15.10.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”;
- Urdhri i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 2457, datë 9.3.2017, " Për miratimin e Rregullores së Brendshme e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ”;
- Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë nr.352, datë 17.6.2019, “Për miratimin e Rregullores së Brendshme e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ”;
- Urdhri i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 222, datë 12.04.2019 "Për krijimin e grupit për menaxhim Strategjik në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë (GMS)”;
- Urdhrin i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 222/1, datë 12.04.2019 "Për krijimin e ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore për hartimin e planit afatmesëm buxhetor për periudhën 2019-2021”;
- Urdhri i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 110, datë 11.5.2020 “Për një shtesë në urdhrin nr. 587, datë 20.12.2019, “Për delegimin e kompetencave”;
- Urdhri i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 158, datë 8.6.2020, “Për delegim kompetence”;
- Urdhri i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 159, datë 8.6.2020, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 587, datë 20.12.2019, “Për delegimin e kompetencave”.

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Ligji nr. 79/2017 “Për sportin”, dat 27.04.2017, i ndryshuar; Neni 8, Ministria përgjegjëse për sportin dhe njësitë e qeverisjes vendore:

- Ministria përgjegjëse për sportin harton dhe zbaton politikën shtetërore në fushën e sportit, plotëson dhe përmirëson kuadrin ligjor të sportit, administron fondet buxhetore për sportin dhe kontrollon përdorimin e tyre nga organizatat sportive.
- Ministria përgjegjëse për sportin bashkë-punon me to për zhvillimin e sportit në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar pavarësinë e funksionimit të tyre, administron objektet sportive publike, që ka në juridiksion, dhe financon ndërtimin e mirëmbajtjen e mjediseve sportive.
- Njësia administrative e pushtetit vendor harton dhe garanton politikat vendore në fushën e sportit shkollor, sportit për të gjithë dhe sportit elitare, krijojnë institucione përgjegjëse për sportin, menaxhon objektet sportive, që ka në pronësi, ndërton objekte të reja, sipas nevojës, mbështet zhvillimin dhe veprimtarinë e organizatave sportive që zhvillojnë veprimtari në territoret e tyre.

Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015. “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 25, Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese:

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Në Vendim nr. 74, datë 27.1.2016 “Për miratimin e planit kombëtar për integrimin evropian 2016–2020”, parashikohet sa vijon;

Ligji 115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Njësitë e qeverisjes vendore (NjQV) janë përgjegjëse për zbatimin e një pjese të madhe të legjislacionit të përafuar me *acquis* të BE-së, që përfshin fusha të rëndësishme si:

- infrastruktura dhe shërbimet publike lokale;
- shërbimet sociale në nivel lokal, shërbimet kulturore dhe sportive;
- zhvillimi ekonomik vendor;
- rendi publik dhe siguria;
- arsimi parashkollor dhe parauniversitar;
- sistemi i kujdesit shëndetësor parësor dhe mbrojtja e shëndetit publik;
- kujdesi social;
- mbrojtja e mjedisit.

2.4 Pesha në buxhet

Referuar raporteve të monitorimit të përgatitura nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për periudhën 2019-2021, fondet e akorduara për MAS, të ndara veças për MAS (totali i fondeve dhe të ndara investimet e MAS dhe të sportit), investimet sipas programit buxhetor për sportin paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela 1. Investimet për programin buxhetor për sportin 2019-2021.

Ministria e Arsimit dhe Sportit	2019		2020		2021	
	Plan i rishikuar + të ardhurat	Realizimi i fondeve ku janë përfshirë dhe të ardhurat	Plan i rishikuar + të ardhurat	Realizimi i fondeve ku janë përfshirë dhe të ardhurat	Plan i rishikuar + të ardhurat	Realizimi i fondeve ku janë përfshirë dhe të ardhurat
Totali i fondeve me burim financimi nga buxhetit i shtetit + të ardhurat, si dhe donacionet;	44,732,847	42,971,701	44,588,439	42,221,371	46,704,740	44,238,971
Nga të cilat për:						
Fonde për Investime (Financime nga buxheti i shtetit + të ardhurat, si dhe donacionet);	4,672,245	4,405,985	3,980,234	3,734,597	2,758,384	1,812,389

Fonde për Investime në Programin e Sportit	250,000	249,764	30,200	14,120	300,000	295,189
Fondet për Investime për Sportin në % kundrejt totalit të investimeve;	5,3%	5,7%	0,8%	0,4%	11%	16,3%

Burimi i të dhënave: MAS (raportet e monitorimit).

Përpunoi: Grupi i Auditimit.

Nga të dhënat rezultojnë se shpenzimet faktike për investimet për sportin për periudhën objekt auditimi paraqiten si më poshtë:

Për vitin 2019 rreth 5.7 % e totalit të shpenzimeve për investime të realizuara

Për vitin 2020 rreth 0.4 % e totalit të shpenzimeve për investime të realizuara

Për vitin 2021 rreth 16.3 % e totalit të shpenzimeve për investime të realizuara

Fondet e sportit për investime të realizuara për periudhën objekt auditimi paraqiten si më poshtë:


Për vitin 2019 249.764 mijë lekë

Për vitin 2020 14.120 mijë lekë

Për vitin 2021 189 mijë lekë.

Investimet e kryera në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe në programin buxhetor për sportin:

Grafiku 1: Paraqitja grafike e fondeve buxhetore për sportin



Burimi i informacionit: MAS

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Tabela 2: Financimi i MAS për terrenet sportive për periudhën 2018- 2020

Në 000/lekë

Emri i Institucionit	Emërtimi produktit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të	Viti i përfundimit	Vlera kontratës	Vlera e bashkefinancimit	Realizimi
----------------------	--------------------	---------------------------	--------------------	--------------------	-----------------	--------------------------	-----------


			projekt it	it te proje ktit		nga NJVQV	TO TA L
Bashkia Ura Vajguror e	Ambjente sportive+Rikonstruksion i shkolles "Astrit Hyka", fshati Kutalli	54,478,229	2018	2019	53,630,77 4	5,447,82 3	87%
Bashkia Librazhd	Ndertim palestre+rikonstr. Shk. Se MB+sistem ngrohje "Rrahman Çota", Hotolisht, B Librazhd	70,762,869	2018	2019	70,638,27 8	7,076,2 87	100 %
Bashkia Roskovec	Rehabilitim i ambienteve sportive+palester shkolla "Alush Grepca", B Rroskovec	57,389,135	2018	2019	56,221,38 2	5,738,9 14	100 %
Bashkia Mirdite	Rikonstruksion i plote i pallatit te sportit "Arjan Arapi", Rreshen	70,598,291	2018	2019	63,269,16 9	7,059,8 29	96%
Bashkia Kurbini	Rindertim i terreneve sportive te shkolles "Mark Trothi", ish poligoni, Laç	39,000,000	2018	2019	38,628,89 6	11,700, 000	100 %
Bashkia Lezhe	Ambjente sportive+rikonstruksion i plote i shkolles MB Balldren, Lezhe	84,300,000	2018	2019	74,182,20 4	25,290, 000	100 %
Bashkia Lezhe	Perfundim i punimeve te palestres se shkolles "Nene Tereza", Lezhe	32,000,000	2018	2019	28,159,05 6	9,600,00 0	100 %
Bashkia Shkoder	Projekti "Jeto me sportin", rikualifikim i terreneve sportive ne shkollen "Oso Kuka" B Shkoder;"Ana e Mali" Oblike; dhe "At Gjon Kama" Guri i Zi	45,102,102	2018	2019	31,471,46 3	13,530, 631	90%
Bashkia Vore	Ambjente sportive+rikonstruksion i shkolles se MB "Shaban Sheshori" godina1, Preze	49,275,888	2018	2019	49,275,88 8	4,927,5 89	100 %
Bashkia Sarande	Rehabilitimi dhe vitalizimi i korpusit dhe terreneve sportive te shkolles "Hoxha Tahsin", B Sarande	64,765,000	2018	2019		19,429, 500	100 %

					63,124,741		
Bashkia Selenice	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare+ndertim palestere, fshati Kote, B Selenice	63,460,877	2018	2019	63,364,409	6,346,088	100 %
Bashkia Prrenjas	Ndertim i fushes se sportit, qyteti Prrenjas	99,053,495	2018	2019	99,053,495	9,905,350	0%

Burimi i të dhënave: MAS

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Grafiku 2: Paraqitja grafike e investimeve në Programin e sportit/Totali fondeve



Burimi i informacionit: MAS

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Tabela 3: Pesha specifike e fondeve(%) e destinuar për Sportin kundrejt fondeve buxhetore totale të periudhës objekt auditimi (2019-2021) për të 5 objektet që janë në auditim:

Nr	Subjektet	Buxheti total per 3 vitet	Buxheti i dedikuar per sportin per 3 vite	Pesha ne % e buxhetit per sportin
1	Ministria e Arsimit dhe Sportit	136,026,026	580,200	0.4%
2	Bashkia Pogradec	3,167,906	94,739	3%
3	Bashkia Prrenjas	1,368,354	3,000	0.2%
4	Bashkia Librazhd	4,158,769	127,165	3%
5	Bashkia Kurbin	1,745,933	35,336	2%

Burimi: Subjektet në auditim

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore referuar disiplinës buxhetore parashikojnë fonde të veta për përmbushjen e funksioneve të veta ku përfshihen dhe ato funksione që kanë për qëllim zhvillimin e sportit. NJVQV përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit, kjo në formën e transfertës së pakushtëzuar e cila miratohet si pjesë integrale e buxhetit vjetor të shtetit. Është pikërisht pjesa Sektoriale e Transfertës së Pakushtëzuar e cila përfshin financimin për disa funksione të transferuara mes të cilave janë Zhvillimi i aktiviteteve sportive në njësinë territoriale që mbulon.

Për auditimin e menaxhimit të terreneve sportive në NJVQV, grupi i auditimit ka marrë dhe shqyrtuar të dhëna nga subjektet e audituara mbi buxhetet e planifikuara dhe realizimet e tyre duke evidentuar ato programe buxhetore që lidhen kryesisht dhe drejtpërdrejtë me çështjet e sportit.

Fondet e akorduara sipas Bashkive/ struktura e sportit, sipas ligjit vjetor të buxhetit (transfertat, dhe të trashëguara dhe nga të ardhurat), si dhe të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak paraqiten si mëposhtëm vijon:

Në mënyrë të detajuar, po paraqesim fondet e akorduara për sportin, sipas secilës bashki:

Bashkia Pogradec

Buxheti i Bashkisë Pogradec është miratuar :

për vitin 2019, me VKB nr.2, datë 04.01.2019;

për vitin 2020 me VKB nr.115, datë 27.12.2020;

për vitin 2021 me VKB nr.144, datë 24.12.2020;

Buxheti i planifikuar dhe i realizuar i Bashkisë së Pogradec dhe shpenzimet e planifikuara dhe të realizuara për Strukturën e Sportit kundrejt Buxhetit total për vitin 2019,2020 dhe 2021, paraqitet si më poshtë:

Tabela 4: Pesha specifike e buxhetit për sportin Bashkia Pogradec

N r.	Emërtimi	2019		2020		2021	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Buxheti i Bashkisë - Total	934,969,673	828,133,443	1,007,166,016	836,757,812	1,225,770,89	979,148,249
2	Buxheti i Sportit	33,835,400	25,730,533	40,737,400	12,169,790	20,166,100	34,288,529
3	Pesha ne % e buxhetit per sportin	3.6	3.1	4	1.45	1.6	3.5

Burimi: Bashkia Pogradec,

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Nga sa më sipër, vihet re se:

- Fondet e planifikuara për sportin zënë për vitin 2019 rreth 3.6% të totalit të fondeve të bashkisë, ndërsa fondet e realizuara për sportin kundrejt buxhetit faktik total të bashkisë zënë 3.1%.
- Fondet e planifikuara për sportin zënë për vitin 2020 rreth 4% të totalit të fondeve të bashkisë, ndërsa fondet e realizuara për sportin kundrejt buxhetit faktik total të bashkisë zënë 1.45%
- Fondet e planifikuara për sportin zënë për vitin 2021 rreth 1.6% të totalit të fondeve të

bashkisë, ndërsa fondet e realizuara për sportin kundrejt buxhetit faktik total të bashkisë zënë 13.5%.

Bashkia Prrenjas

Buxheti i Bashkisë Prrenjas është miratuar:

për vitin 2019 me VKB nr.25, datë 05.04.2019;

për vitin 2020 me VKB nr.141, datë 20.12.2019;

për vitin 2021 me VKB nr.107, datë 30.12.2020.

Buxheti i planifikuar dhe i realizuar i Bashkisë Prrenjas dhe shpenzimet e planifikuara dhe realizuara për Strukturrën e Sportit kundrejt Buxhetit total për vitin 2019,2020 dhe 2021, paraqitet si më poshtë:

Tabela 5: Pesha specifike e buxhetit për sportin Bashkia Prrenjas

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	2019		2020		2021	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Buxheti i Bashkisë - Total	400,784,346	268,356,670	468,490,772	344,269,294	499,078,916	396,960,918
2	Buxheti i Sportit	0	0	1,500,000	0	1,500,000	0
3	Pesha ne % e buxhetit per sportin	0	0	0.3	0		0.4

Burimi: Bashkia Prrenjas,

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Sa i përket programeve të dedikuara për sportin(terrenet sportive), në Bashkinë Prrenjas për periudhën e auditimit nuk rezulton të jenë planifikuar fonde për investime për ngritje terrenesh sportive dhe rrjedhimisht nuk ka as realizim të tij. Por duhet theksuar fakti se Bashkia Prrenjas, në vitin 2019 ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim i fushës së re të sportit, qyteti Prrenjas”. Ndërtimi i këtij objekti sportiv është parashikuar të financohej me fonde buxhetore nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në shumën totale të projektit 99,053,495 lekë. Mirëpo, kjo procedurë prokurimi është anuluar nga Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) me Vendimi nr. 217/2019 i datës 15.04.2019. Për këtë procedurë prokurimi, i gjithë dokumentacioni është sekuestruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan me Vendim Sekuestrimi dt.13.02.2019 për procedimin penal Nr.303 të vitit 2019.

Bashkia Librazhd

Buxheti i Bashkisë Librazhd është miratuar:

për vitin 2019, është miratuar me VKB nr.2138, datë 24.12.2018;

për vitin 2020 me VKB nr.149, datë 30.12.2019;

për vitin 2021 me VKB nr.120, datë 29.12.2020;

Buxheti i planifikuar dhe i realizuar i Bashkisë Librazhd dhe shpenzimet e planifikuar dhe të realizuara për Strukturrën e Sportit kundrejt Buxhetit total për vitin 2019,2020 dhe 2021, paraqitet si më poshtë:

Tabela 6: Pesha specifike e buxhetit për sportin Bashkia Librazhd

Në 000/lekë

N r.	Emërtimi	2019		2020		2021	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Buxheti i Bashkisë -Total	1,330,221,285	1,185,040,285	1,427,714,145	1,269,913,233	1,400,833,946	1,254,932,856
2	Buxheti i Sportit	102,480,182	102,415,109	12,685,000	12,685,000	12,000,000	12,000,000
3	Pesha ne % e buxhetit per sportin	7.7	8.6	0.9	1	0.9	1

Burimi: Bashkia Librazhd,

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Nga sa më sipër, vihet re se:

- Fondet e planifikuara për sportin zënë për vitin 2019 rreth 7.7% të totalit të fondeve të bashkisë, ndërsa fondet e realizuara për sportin kundrejt buxhetit faktik total të bashkisë zënë 8.6%.
- Fondet e planifikuara për sportin zënë për vitin 2020 rreth 0.9% të totalit të fondeve të bashkisë, ndërsa fondet e realizuara për sportin kundrejt buxhetit faktik total të bashkisë zënë 1%
- Fondet e planifikuara për sportin zënë për vitin 2021 rreth 0.9% të totalit të fondeve të bashkisë, ndërsa fondet e realizuara për sportin kundrejt buxhetit faktik total të bashkisë zënë 1%.

Bashkia Kurbin

Buxheti i Bashkisë Kurbin është miratuar:

për vitin 2019, me VKB nr. 171 datë 12.12.2018 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2019”;

për vitin 2020 me VKB nr. 58 dt 27.12.2019“Per miratimin e buxhetit te vitit 2020”;

për vitin 2021 me VKB nr. 156 dt 14.12.2020 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2021”;

Tabela 7: Pesha specifike e buxhetit për sportin Bashkia Kurbin

Në 000/lekë

N r.	Emërtimi	2019		2020		2021	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Buxheti i Bashkisë - Total	536,803,226	429,448,700	574,472,788	412,680,895	634,657,105	509,573,239
2	Buxheti i Sportit	10,702,400	9,155,371	12,081,270	11,122,276	12,552,877	12,272,475

3	Pesha ne % e buxhetit per sportin	2	2.1	2.1	2.7	2	2.4
---	-----------------------------------	---	-----	-----	-----	---	-----

Burimi: Bashkia Kurbin,

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Nga sa më sipër, vihet re se:

- Fondet e planifikuara për sportin zënë për vitin 2019 rreth 2% të totalit të fondeve të bashkisë, ndërsa fondet e realizuara për sportin kundrejt buxhetit faktik total të bashkisë zënë 2.1%.
- Fondet e planifikuara për sportin zënë për vitin 2020 rreth 2.1% të totalit të fondeve të bashkisë, ndërsa fondet e realizuara për sportin kundrejt buxhetit faktik total të bashkisë zënë 2.7%.
- Fondet e planifikuara për sportin zënë për vitin 2021 rreth 2% të totalit të fondeve të bashkisë, ndërsa fondet e realizuara për sportin kundrejt buxhetit faktik total të bashkisë zënë 2.4%.

2.5 Feedback-u i subjektit gjatë auditimit

Gjatë gjithë periudhës së auditimit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Bashkitë Librazhd, Pogradec, Prrenjas, Kurbin i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë takimeve konsultuese, intervistave si edhe plotësimit të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar që lidhet me vjeljen e të dhënave plotësuese mbi subjektet. Vlen të theksohet gadishmëria dhe disponibiliteti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkive, subjekt i këtij auditimi, në lidhje me kërkesat e grupit të auditimit.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën PESTLE duke marrë në konsideratë risqet e gjashtë fushave të ndryshme në të cilat shtrihet kjo analizë e respektivisht në nivelin politik, ekonomik, social, teknologjik, ligjor për sportin. Analiza PESTLE është një mjet i rëndësishëm që ndihmon në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në funksionimin e një institucioni apo procesi të caktuar.⁸ Gjatë përdorimit të kësaj analize është e rëndësishme që faktorët që ndikojnë në funksionimin e procesit për të cilën kjo analizë kryhet, jo vetëm të identifikohen por edhe të vlerësohen aty ku është e mundur. Kjo analizë risku ka karakter paraprak dhe në vazhdimësi të auditimit, nëse do të jetë e nevojshme, do të kryhet një rivlerësim dhe/ose përditësim i risqeve të identifikuara. Kjo analizë krahas risqeve që lidhen me politikat është fokusuar edhe në risqet ekonomike, sociale e mjedisore duke qenë se politikat mjedisore kanë pasoja drejtpësdrejtë në të tre këto fusha.

⁸ ëëë.free-management-ebooks.com. 2013 ISBN 978-1-62620-998-5


Tabela. 6: Analiza e Riskut

P Political	E Economic	S Social	T Technological	L Legal	E Environment
*Zgjedhjet vendore në vitin 2019 dhe efekti në zgjedhjet parlamentare në vitin 2021 mund të kenë ndikuar veprimtarinë e NJVQV. *Kriza politike dhe efektet në përfaqësimin e plotë të spektrit politik. *Ndikimi i Pandemisë në kufizimet që mund shkaktojë *Mungesa e dokumentave strategjike në nivel qendror.	*Mungesë buxhetesh të dedikuara për politikat për sportin *Mungesë e analizave të thelluara që mund të rezultojnë me tejkalim të buxheteve të parashikuara *Ulja e të ardhurave dhe rritja e shpenzimeve në buxhetet e NJVQV si pasojë e fatkeqësive natyrore *Kosto të larta për ngritjen e terreneve sportive sipas standardeve në tërësi.	*Mungesa e terreneve sportive në tërësi ka impakt të fortë dhe ndikon cilësinë e jetës së rinisë, dhe të komunitetit. *Mungesa e konsultimit me grupet e interesit, me komunitetin gjatë hartimit të politikave për sportin *Mungesa e transparencës me grupet e interesit, komunitetin për problemet e ngritjes së infrastrukturës sportive *Mungesë e fushatave ndërgjegjësuere në funksion të ngritjes së terreneve sportive .	*Ndërtimet pa kriteret pa plane afatgjatë me impakt negativ në mungesa të terreneve sportive. *Mungesa e standardeve për pajisje dhe mjete në infrastrukturën egzistuese në terrenet sportive.	*Mungesa e një plan veprimi të qartë dedikuar për zhvillimin e sportit dhe e dokumenteve strategjike *Krijimi i një strukture efikase të dedikuar për sportin *Mungesa e akteve nën ligjore nga MAS në lidhje me standardet që duhen në ngritjen e infrastrukturës sipas llojit të sporteve. *Mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit mes aktorëve të përfshirë në zbatimin e politikave kombëtare për sportin *Mosfunksionimi i sistemit të raportimit për çështjet e sportit.	*Pasoja e fatkeqësive natyrore të nëntorit 2019 të cilat shkaktuan dëme në infrastrukturën e terreneve sportive sidomos në shkollat. *Lëvizjet demografike dhe krijimi i poleve urbane.

3.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Menaxhimi i terreneve sportive” në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe në NJVQV ka patur si objektiv kryesor vlerësimin e politikave dhe efektivitetin e tyre në fushën e zhvillimit të sportit, duke u fokusuar kryesisht në rolin dhe përgjegjësitë që subjektet nën auditim kanë. Në këtë mënyrë qasja e auditimit ka synuar të sigurojë një vlerësim të paanshëm dhe objektiv mbi kompetencat dhe përgjegjësitë që Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe NJVQV kanë në fushën e sportit, strukturat e ngritura dhe politikat e hartuara në drejtim të zhvillimit të sportit në përgjithësi e në veçanti të terreneve sportive. Nëpërmjet objektivit të auditimit kemi arritur të konkludojmë lidhur me politikëbërjen në nivel qendror dhe lokal për zhvillimin e sportit në tërësi dhe terrenet sportive në mënyrë të veçantë.

3.3 Pyetjet e auditimit



3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka patur si fushëveprimi analizimin dhe dhënien e një opinionit mbi efektivitetin e menaxhimit të terreneve sportive si në nivelin e politikave ashtu edhe këndvështrimin e NJVQV. Auditimi për shkak të kompleksitetit të tij pati një qasje në nivel makro duke parë nga perspektiva e detyrimeve që NJVQV kanë në lidhje me zbatimin e politikave për sportin në nivel qendror nëpërmjet zbatimit në nivel vendor. Në këtë auditim nuk jemi fokusuar specifikisht në procedura dhe procese të veçanta duke qenë se fokusi ynë ishte kryesisht drejt politikave të hartuara dhe si implementohen ato nga ana e NJVQV, duke u fokusuar te terrenet sportive. Periudha e cila u auditua ishte 2019-2021. Gjatë këtij auditimi u fokusua te Ministria e Arsimit dhe Sportit, si organ politikëbërës dhe bashkitë Pogradec, Librazhd, Prrenjas dhe Kurbin. Numri i lartë i subjekteve të përzgjedhur është për të patur një panoramë më të plotë lidhur me fokusin e auditimit në këndvështrimin e politikave të hartuara për sportin dhe menaxhimin e terreneve sportive në 4 bashkitë e përzgjedhura.

4. SHTJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE

A ka qenë efektiv menaxhimi i terreneve sportive në nivel qendror e vendor për periudhën 2019-2021?

Mesazhi i auditimit

Menaxhimi i terreneve sportive në Shqipëri, pavarësisht punës dhe përpjekjeve në nivel qendror e lokal, nuk ka rezultuar mjaftueshëm efektiv në drejtim të ngritjes, funksionimit dhe monitorimit të tij.

Mungesa e një strategjie të miratuar për sportin nga Ministria e Arsimit dhe Sportit ka cenuar realizimin e objektivave për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe veprimtarive të tjera rekreative me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve që të merren me edukim fizik dhe sport në përputhje me Kartën Evropiane të Sportit si dhe me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në këtë fushë.

Mungesa e strukturave të veçanta për menaxhimin e terreneve sportive në nivel qendror dhe lokal dhe funksionimi jo në nivelin e duhur i disa strukturave përgjegjëse për zhvillimin e sportit në tërësi dhe në veçanti për menaxhimin e terreneve sportive, tregon qartë se këto institucione vuajnë nga një mungesë menaxhimi me eficiencë dhe efektivitet të ambienteve, terreneve dhe objekteve sportive.

Mungesa e një database të plotë të ambienteve dhe objekteve sportive bart risk lidhur me identifikimin e nevojave për menaxhimin e terreneve ekzistuese dhe ngritjen e atyre të reja. Niveli i ulët i financimeve si nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe nga vetë NJVQV, si edhe puna e pamjaftueshme për gjetjen e burimeve alternative të financimit është tregues për mungesën e efektivitetit në menaxhimin e terreneve sportive.

Nga auditimi i këtij aktiviteti në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe në 4 Bashkitë Librazhd, Prrenjas, Pogradec, Kurbin, rezultoi se masat e marra për zhvillimin e sportit dhe ngritjen e terreneve sportive janë të pamjaftueshme për të siguruar mjedise për zhvillimin e veprimtarive sportive, të sigurta dhe sipas standardeve bashkëkohore, jo vetëm për arsimin para universitar por dhe për komunitetin.

4.1 A janë hartuar politikat e duhura për sportin, të cilat përfshijnë edhe terrenet sportive?

4.1.1 A janë hartuar dhe miratuar strategji kombëtare për sportin ose dokumenta të tjerë politikë për zhvillimin e sportit?


Sporti në Republikën e Shqipërisë është një veprimtari publike.⁹ Shteti nxit zhvillimin e sportit shkollor, sportit për të gjithë dhe sportit elitë, duke mbështetur pjesëmarrjen e shtetasve në sport, nëpërmjet krijimit të kushteve ligjore, financiare dhe të infrastrukturës sportive.¹⁰

Konceptuar si i tillë ai meriton vëmendje dhe rëndësi të veçantë.

Ministria e Arsimit dhe Sportit ka detyrimin ligjor për hartimin e politikave kombëtare në fushën e sportit, si ministria përgjegjëse për sportin në vend. Nëse arsimi është shtylla e parë e drejtimit të këtij institucioni, sporti është shtylla e dytë pasuese e saj. Kjo do të thotë se përgatitja e programeve dhe orientimeve strategjike nuk duhet parë thjesht dhe vetëm si detyrim normativ, por njëherësh si faktor i qenësishëm institucional i kësaj ministrie. Ligji 79/2017, datë 27.04.2017 “Për Sportin”, i ndryshuar në Nenin 8 Pika 1, përcakton: Ministria përgjegjëse për sportin harton dhe zbaton politikën shtetërore në fushën e sportit, plotëson dhe përmirëson kuadrin ligjor të sportit, administron fondet buxhetore për sportin dhe kontrollon përdorimin e tyre nga organizatat sportive.

Në organigramën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit dhe Sportit, e cila ka edhe kompetencën për hartimin e dokumentave politikë që lidhen me sportin ka në varësi

Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë brenda së cilës është edhe Sektori i Politikave dhe Strategjive të Sportit dhe Rinisë.



Nga evidencat e siguruar nga subjekti si dhe përgjigjet e intervistave, në përputhje edhe me kriteret e listuar në programin e auditimit, rezultojnë se: Strukturat përgjegjëse të sportit në Ministrinë e Arsimit

⁹ Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” Neni 8, Pika 1

¹⁰ Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” Neni 8, Pika 2

dhe Sportit i referohen SKZHI 2015-2020 dhe Programeve të Buxheteve Afatmesme si të vetmet dokumente strategjike tek të cilat bazohen për zhvillimin e aktiviteteve të sportit.

Nga kërkesa e grupit të auditimit, për të vlerësuar raportimet e strukturës përgjegjëse të sportit për nivelin e lartë drejtues, mbi realizimin e aktiviteteve të planeve operacionale, nuk ka informacione në lidhje me mos financimet e ngritjes së infrastrukturës sportive në rang kombëtar por rezulton se: Raportimet vjetore të sektorit përgjegjës për sportin në MAS nuk kanë në përmbajtjen e tyre shenjëstrime të shprehura në mënyrë eksplicite për zhvillim e sportit, domosdoshmërinë e ngritjes së terreneve sportive në rang kombëtar. Përveç përmirësimit të kuadrit ligjor, në asnjë rast është shprehur domosdoshmëria e rritjes së investimeve në infrastrukturën sportive në përgjithësi me synim nxitjen e zhvillimit të sportit në nivel lokal dhe kombëtar.

Referuar SKZHI 2015-2020 faqe (162) Kapitulli– Forcimi i rolit të sportit, përcaktohej si objektivi përmirësimi i infrastrukturës sportive dhe nivelit të pjesëmarrjes në veprimtaritë sportive nëpërmjet: Përmirësimeve të kuadrit ligjor për sportet dhe financimin e tyre.

Konkretisht në fushën e legjislacionit sportiv ndryshimet janë kryer me:

Miratimin e ligjit të ri “Për Sportin” 79/2017, i ndryshuar më datë 29.07.2020, i cili përmirësoi kudrin ligjor në lidhje me :

- Rritjen e autonomisë dhe krijimin e mundësive për vetë menaxhim të organizatave sportive kombëtare dhe lokale, nëpërmjet përcaktimit të kompetencave të pushteteve dhe lëvizjes sportive (federata, shoqata dhe klube), me synim rritjen dhe forcimin e demokracisë së brendshme, të organizatave sportive, ndërgjegjësimin dhe disiplinimin në përdorimin e fondeve që ato përfitojnë nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat dytësore, në respektim të kritereve të përcaktuara për sportin.
- Përfshirjen për herë të parë të edukimit fizik dhe sportit shkollor në një kapitulli të veçantë, si dhe përcaktimin e kufirit minimal të ngarkesës mësimore të lëndës së edukimit fizik në kurrikulën bërthamë, organizimin e federatave të sportit shkollor dhe universitar, në funksion të institucionalizimit dhe organizmit të veprimtarisë sportive në institucionet arsimore.
- Reformimin e organeve konsultative të Këshillit të Lartë të Sportit dhe Komisionit Kombëtar Kundër Dhunës në Sport, si dhe përcaktimin jo-politik të përbërjes së tyre, për të synuar partneritet më të fortë ndërinstitucional.
- Përcaktimin e statusit juridik të klubeve sportive, i cili do t’i japë status ligjor klubeve sportive aktuale, si dhe përfshirjen e llojit të klubeve “shumë sportesh”, pasi në ligjin aktual mungon.
- Përkufizimin e ri të nenit 31 “mbi objektet sportive”, me qëllim moslejimin e ndryshimit të destinacionit të objekteve dhe terreneve sportive nga privatizimi apo dhënia me koncesion i tyre.

I vetmi dokument strategjik i hartuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Strategjia Kombëtare për Arsimin(SKA) 2021-2026, e miratuar me VKM nr.621, datë 22.10.2021, ka si objektivi garantimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës dhe i bazuar në parimet e barazisë dhe mësimi gjatë gjithjetës, që mundëson formimin cilësor të të gjithë individëve, duke kontribuar në mirëqenien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Gjithashtu në Nenin 9, Pika 1 të Ligjit 79/2017, datë 27.04.2017 “Për Sportin”, i ndryshuar, përcaktohet edhe Këshilli i Lartë i Sportit, si organ këshillimor, pranë ministrit përgjegjës për sportin, i cili merr pjesë në hartimin dhe zhvillimin e politikave për sportin.

Këshilli i Lartë i Sportit, u ngrit me Urdhër nr. 337, datë 20.06.2018 “ Për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Sportit” të ish Titullarit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në bazë të cilit janë emëruar anëtarët e Këshillit të Lartë të Sportit.

Ministri përgjegjës për sportin është njëkohësisht edhe kryetar i Këshillit të Lartë të Sportit dhe emëron anëtarët e tij.¹¹

¹¹ Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” Neni 9, Pika 3

Nga kërkesa e grupit të auditimit, për të vlerësuar raportimet e strukturës përgjegjëse të sportit për nivelin e lartë drejtues, mbi realizimin e aktiviteteve të planeve operacionale, nuk ka informacione në lidhje me mos financimet e ngritjes së infrastrukturës sportive në rang kombëtar por rezulton se: Raportimet vjetore të sektorit përgjegjës për sportin në MAS nuk kanë në përmbajtjen e tyre shenjëstrime të shprehura në mënyrë eksplicite për zhvillim e sportit, domosdoshmërinë e ngritjes së terreneve sportive në rang kombëtar. Përveç përmirësimit të kuadrit ligjor, si hartimi i Ligjit Nr.79/2017 “Për sportin”, por në asnjë rast domosdoshmëria e rritjes së investimeve në infrastrukturën në përgjithësi dhe atij në arsimin para universitar me qëllim për ti shërbyer sportit në përgjithësi dhe atij profesional, në nivel lokal dhe kombëtar, objekt i këtij auditimi.

Gjetje nga auditimi

1. Ministria e Arsimit dhe Sportit harton dhe zbaton politikën shtetërore në fushën e sportit si edhe plotëson dhe përmirëson kuadrin ligjor të sportit, me synim nxitjen dhe zhvillimin e sportit. Nga auditimi rezulton se ende nuk është hartuar një strategji për sportin në të cilën të orientohen politikat për zhvillimin e sportit në vend edhe pse sporti në Republikën e Shqipërisë është një veprimtari me interes publik.¹² Mungesa e vizioneve të qarta për zhvillimin e sportit, e në veçanti për ngritjen e infrastrukturës sportive, nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ka sjellë mos angazhimin e saj në realizimin e studimeve të mirëfillta dhe analizave kosto-përfitim mbi ngritjen e infrastrukturës sportive sipas nevojave në nivel kombëtar në sistemin arsimor parauniversitar.
2. Këshilli i Lartë i Sportit është një organ këshillimor pranë Ministrit, i cili merr pjesë në hartimin dhe zhvillimin e politikave për sportin, për periudhën objekt auditimi nuk rezulton të ketë funksionuar. Në përbërjen e Këshillit të Lartë të Sportit nuk është ndryshuar Kryetari dhe nuk është miratuar rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Lartë të Sportit, referuar akteve ligjore që përcaktojnë rregullat e funksionimit dhe organizimit të tij.

Konkluzione

1. Mungesa e politikave të zhvillimit të sportit në tërësi, pa programe të qarta, të mbështetura në objektiva afatgjatë dhe me burime të sigurta financimi sjell si pasojë kufizimin e ngritjes së mjediseve dhe terreneve sportive të destinuara për organizim të veprimtarive sportive apo veprimtari sportive rekreative. Mungesa e një strategjie për sportin në mënyrë të vecantë nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ndër vite, ka sjellë mungesë orientimi të drejtë të politikave dhe angazhimeve qeveritare mbi sportin. Programet e Buxheteve Afatmesme nuk mund të jenë e vetmja pikë orientimi e strukturave përgjegjëse të sportit, duke qenë se vetë ky dokument hartohet dhe detajohet specifikisht për vlerësimet financiare të detyrave mikro të fushës respektive. Strategjitë si edhe orientimet ligjore ku mbështetet Ministria e Arsimit për përpilimin e tyre, duhet të bazohen mbi analizën e gjendjes aktuale të sportit, vizionin mbi sektorin, objektivat që duhen arritur nëpërmjet planeve të veprimit me indikatorë të matshëm, aktorët relevantë, organizatat përgjegjëse dhe mjetet e nevojshme financiare, me qëllim hartimin e dokumenteve që sigurojnë vazhdimësi.
2. Mungesa e funksionimit dhe ristrukturimit sipas ndryshimeve nga titullari i institucionit si dhe e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Lartë të Sportit ka sjellë mos angazhimin e tij si organ këshillimor, në hartimin dhe zhvillimin e politikave për sportin, gjë që ka ndikuar në më pak vëmendje për sportin dhe në mungesë financimesh për infrastrukturën sportive në veçanti.

Rekomandime

- 1.1 Ministria e Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Sportit dhe grupet e interesit të ngrejë grupet e punës për hartimin e dokumentit strategjik për zhvillimin e sportit

¹² Ligji Nr. 105/2020, neni 2, Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin”

në vend, shoqëruar me plan veprimi konkret nëpërmjet një analize të thelluar të situatës së sportit në vend.

Brenda vitit 2022

- 1.2 Ministria e Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, pushtetit vendor, të marrë masa për të zhvilluar plane operacionale kombëtare të zhvillimit të sportit me objektiva të qarta, të matshme dhe të arritshme për ngritjen e infrastrukturës sportive, sipas standardeve në nivel kombëtar.

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2023

- 2.1 Ministria e Arsimit dhe Sportit të mundësojë funksionimin normal të Këshillit të Lartë të Sportit duke riformatuar këtë organ, pas ndryshimeve në kryera në institucion, për një funksionim sa më efektiv të veprimtarisë së këtij organi këshillimor në realizimin e misionit të politikëbërjes për zhvillimin e sportit. Titullari i institucionit, të ngrejë grupe pune për hartimin dhe miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Lartë të sportit, duke përcaktuar qartë se çfarë produkti pritët prej tij, në mënyrë që të sigurojë funksionimin me efikasitet të tij.

Brenda vitit 2022

4.1.2 Si ka qenë niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit mes aktorëve në politikat e hartuara e të zbatuara?

Për periudhën objekt auditimi, referuar bashkëpunimit institucional ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Njësitë të Vetë Qeverisjes Vendore, Librazhd, Prrenjas, Pogradec dhe Kurbin, auditimi u fokusua në hartimin e pyetësorëve dhe intervistave verbale me punonjësit e strukturave të sportit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe të bashkive respektive.

Gjetje nga auditimi

3. Dokumentacioni i paraqitur në lidhje me politikat e bashkive për zhvillimin e sportit e në veçanti për terrenet sportive, nuk ka qenë në fokus të bashkëpunimit institucional, pasi nuk rezulton nga auditimi, ndonjë informacion, relacione, udhëzime, apo marrëveshje bashkëpunimi, për këtë qëllim si në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ashtu edhe në bashkitë objekt auditimi. Niveli i bashkëpunimit ka rezultuar vetëm në kërkesat që bashkitë i kanë drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për financime që lidhen me rindërtimin e shkollave të sistemit bazë dhe të mesme, duke përfshirë edhe mjedise sportive (palestra dhe terrene sportive). Por jo në të gjitha rastet Ministria e Arsimit dhe Sportit, i është përgjigjur këtyre kërkesave, duke influencuar në këtë mënyrë nivelin e ngritjes dhe zhvillimit të ambienteve sportive.
4. Ministria e Arsimit dhe Sportit harton dhe zbaton politikën shtetërore në fushën e sportit, plotëson dhe përmirëson kuadrin ligjor të sportit, administron fondet buxhetore për sportin dhe kontrollon përdorimin e tyre nga organizatat sportive. Gjithashtu ajo bashkëpunon për zhvillimin e sportit në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar pavarësinë e funksionimit të tyre.¹³ Nga auditimi rezulton mungesë bashkëpunimi, shkëmbim informacioni apo marrëveshje të finalizuara me objektiva të përcaktuara për zhvillim e sportit, e në veçanti për nevojat e komunitetit për mjedise sportive në nivel kombëtar.

(Rajtuar më hollësisht në faqet 26-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Konkluzione

3. Mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit mes pushtetit qendror dhe atij vendor, cenon arritjen e objektivave të përbashkët për nxitjen dhe zhvillimin e sportit në tërësi. Mungesa e

¹³ Ligjin Nr. 79/2017 "Për Sportin", i ndryshuar, Nenin 8, pika 1, 2.

një komunikimi aktiv mes strukturave përgjegjëse për sportin pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe strukturave përgjegjëse pranë NJVQV-ve, ndikon në identifikimin e nevojave, informacionin mbi terrenet sportive që secila nga njësitë vendore ka nën juridiksion dhe perspektivën për zhvillimin e mëtejshëm të tyre, duke influencuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në politika jo efektive për sportin.

Rekomandime

- 3.1 Nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (bashkitë), të hartohen akte normative për të kryer bashkëpunime reciproke në lidhje me planifikimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e mjediseve sportive në juridiksionet respektive, në përputhje me aktet ligjore që rregullojnë këtë fushë.

Menjëherë

- 4.1 Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të vlerësojnë mekanizma për nxitjen e komunikimit dhe bashkëpunimit mes tyre me synim zhvillimin e sportit në tërësi dhe në mënyrë të veçantë menaxhimin e terreneve sportive.

Në vijimësi

- 4.2 Ministria e Arsimit dhe Sportit në cilësinë e Organit Qendror, të bashkëpunojë dhe të ndihmojë NJVQV-të me financime buxhetore dhe me dhënie konsulence me synim hartimin e strategjive dhe politikave të sportit në nivel vendor dhe në veçanti për ndërtimin, rikonstruksionin dhe menaxhimin e terreneve, objekteve dhe ambienteve sportive, sipas standardeve dhe përvojave më të mira ndërkombëtare.

Në vijimësi

A janë ngritur strukturat e duhura dhe të nevojshme në nivel qendror e lokal për menaxhimin e terreneve sportive?

4.2.1 A janë marrë masa për ngritjen e strukturave të përshtatshme në nivel qendror të cilat përmbushin nevojat për menaxhimin e terreneve sportive?

Për të vlerësuar nëse Ministria e Arsimit dhe Sportit ka qenë efektive në ngritjen e strukturave përgjegjëse të sportit dhe në veçanti të menaxhimit të terreneve sportive, grupi i auditimit përdori kritere, burimi i të cilave ishin:

Ligji nr. 79/2017 “Për sportin”,

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 13.9.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”

Urdhri i Ministrit nr. 2457, datë 9.3.2017, " Për miratimin e Rregullores së Brendshme e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”

Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë nr.352, datë 17.6.2019, “Për miratimin e Rregullores së Brendshme e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ”


Urdhri i Kryeministrit nr.163, datë 15.10.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë” dhe dokumentacionin e fondeve për investime të dhëna për Njësitë Vendore kryesisht për, për ngritjen dhe rikonstruksionin e terreneve sportive, për periudhën 01.01.2019-31.12.2021.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe përgjigjet e intervistave të zhvilluar me stafin e strukturave që mbulojnë fushën e sportit në ministri, me qëllim dhënien e përgjigjeve të kësaj pyetje, rezultoi se:

Struktura e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për periudhën objekt auditimi është miratuar me Urdhrin nr.163, datë 05.10.2017 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së

Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, i ndryshuar me Urdhrin nr.173, datë 10.10.2017 të Kryeministrit.

Në përbërje të kësaj strukture është ngritur dhe funksionon “Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, si më poshtë:



Burimi: MAS

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Konstatohet se për vitet 2019-2021, sektori i sportit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, nuk ka funksionuar si linjë më vete, por ka funksionuar brenda “Drejtorisë së Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë” e ndarë në 3 (tre) Drejtori, ku secila Drejtori ka në linjë 4 apo 5 sektor, duke e integruar kështu, fushën e sportit së bashku me fushën Arsimit dhe të Rinisë. Ndërkohë që VKM nr. 505, datë 13.9.2017, ka përcaktuar fushat e përgjegjësisë së kësaj ministrie dhe i ka ndarë në: fushën e Arsimit, fushën e Sportit dhe në fushën e Rinisë.

Konkretisht, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë” ka në organikë 46 punonjës dhe përbëhet nga 3 drejtori me 14 sektor:

Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë e përbërë nga 4 sektorë me 13 punonjës, nga të cilët:

1 Drejtor Drejtorie;

1 Përgjegjës Sektori i Politikave dhe Strategjive të Arsimit

2 Specialistë;

1 Përgjegjës Sektori i Politikave dhe Strategjive të Kërkimit Shkencor

2 Specialistë;

1 Përgjegjës Sektori i Politikave dhe Strategjive të Sportit dhe Rinisë

2 Specialistë;
1 Përgjegjës Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave
2 Specialistë.

Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë e përbërë nga 5 sektorë me 16 punonjës, nga të cilët:

1 Drejtor Drejtorie
1 Përgjegjës Sektori i Programeve të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar
2 Specialistë
1 Përgjegjës Sektori Programeve të Zhvillimit të Arsimit të Lartë
2 Specialistë
1 Përgjegjës Sektori Programeve të Zhvillimit të Kërkimit Shkencor
2 Specialistë
1 Përgjegjës Sektori Programeve të Zhvillimit të Sportit
2 Specialistë
1 Përgjegjës Sektori Programeve të Zhvillimit Rinor
2 Specialistë.

Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Arsimit, Sportit dhe Rinisë përbërë nga 5 sektorë me 16 punonjës, nga të cilët:

1 Drejtor Drejtorie;
1 Përgjegjës Sektori i Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve në Arsimin Parauniversitar
2 Specialistë;
1 Përgjegjës Sektori i Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve në Arsimin e Lartë
2 Specialistë;
1 Përgjegjës Sektori i Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve në Kërkimin Shkencor
2 Specialistë;
1 Përgjegjës Sektori i Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve në Sport
2 Specialistë;
1 Përgjegjës Sektori i Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve Rinore
2 Specialistë;

Gjetje nga auditimi

5. Struktura dhe organigrama e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, nuk ka të përfshirë një njësi të posaçme për zhvillimin e sportit si dhe specialistë të mirëfilltë që të merren me hartimin dhe ndjekjen e strategjive dhe politikave të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për menaxhimin dhe administrimin e terreneve, objekteve, mjediseve dhe ambienteve sportive në rang kombëtar. Kjo strukturë nuk vjen në përputhje me aktet ligjore që rregullojnë funksionimin dhe organizimin e sportit në Republikën e Shqipërisë.
6. Në Rregulloren e Brendshme të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ¹⁴nuk janë përcaktuar qartë dhe në mënyrë shteruese detyrat dhe funksionet e sportit brenda Drejtorisë dhe sektorëve përgjegjës të sportit, struktura këto që lidhen dhe merren ngushtësisht me zhvillimin e fushës së sportit në tërësi. Po kështu në këtë rregullore nuk janë përfshirë dhe përcaktuar detyrat, kompetencat, përgjegjësitë dhe përkrahjet e punës individuale, si të drejtorëve ashtu dhe të punonjësve të tjerë që janë brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të cilët merren në mënyrë të veçantë me zhvillimin e sportit.

Konkluzione

¹⁴ Urdhri i Ministrit Nr .352, datë 17.6.2019, neni 14 i Rregullores së Brendshme

4. Mungesa e strukturës së veçantë dhe e burimeve njerëzore në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për menaxhimin e terreneve sportive në nivel qendror dhe funksionimi jo në nivelin e duhur është tregues i efektivitetit të ulët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në ushtrimin e funksioneve të saj në lidhje me hartimin e strategjisë dhe politikave të sportit në tërësi dhe të menaxhimit të terreneve sportive në veçanti, si në rang vendi, ashtu dhe në ndihmë të NJVQV-ve dhe institucioneve të tjera të lidhura me sportin.
5. Mungesa e përcaktimit qartë në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të detyrave, kompetencave, përgjegjësisë dhe përshtatësive të punës, të drejtorisë, të sektorëve dhe të specialistëve për sportin, mund të çënojë përmbushjen me sukses të objektivave që lidhen me zhvillimin në tërësi të sportit dhe në veçanti të menaxhimit të ambienteve, terreneve dhe objekteve sportive në nivel kombëtar.

Rekomandime

- 5.1 Ministria e Arsimit dhe e Sportit të marrë masa, për ndryshimin e strukturës organizative të saj me synimin ngritjen në nivel Drejtorie të Përgjithshme apo Drejtorie si njësi e posaçme për zhvillimin e sportit. Në përbërje të strukturës që merret me zhvillimin e sportit të ngrihet në nivel sektori apo të përfshihen në organikë specialistë të kualifikuar për menaxhimin dhe administrimin e terreneve, objekteve, ambienteve dhe pajisjeve sportive.

Menjëherë

- 6.1 Ministria e Arsimit dhe Sportit, të përditësojë Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit, duke përcaktuar në mënyrë shteruese: detyrat, kompetencat, përgjegjësitë dhe përshtatësitë të punës, të strukturave dhe punonjësve që merren me zhvillimin e sportit.

Menjëherë

- 6.2 Ministria e Arsimit dhe Sportit në respektim të kërkesave të akteve ligjore që rregullojnë fushën e sportit¹⁵, të sigurojë mbështetje financiare me qëllimin e vetëm, trajnimin dhe kualifikimin e punonjësve që merren me zhvillimin e sporteve të të gjitha niveleve.

Në vijimësi

4.2.2 A ekzistojnë strukturat e nevojshme dhe të përshtatshme në NJVQV për menaxhimin e terreneve sportive?

Për të vlerësuar nëse 4 (katër) Njësitë Vendore që janë nën auditim, kanë qenë efektive në ngritjen e strukturave përgjegjëse të sportit dhe në veçanti të menaxhimit të terreneve sportive, grupi i auditimit përdori kritere, burimi i të cilave ishin::

Ligji nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”

Ligji nr. 79/2017 “Për sportin”;

Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”

Ligji nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;

Rregulloret e Brendshme e NJVQV

Vendimet e Kryetarëve të bashkive për miratimin e strukturave të Njësive Vendore përkatëse

Vendimet e Këshillave Bashkiakë për miratimin e fondeve për investime nga këto Njësitë Vendore për ndërtimin dhe rikonstruksionin e terreneve sportive.

Bashkia Pogradec:

Për periudhën objekt auditimi 2019-2021, organika dhe organizimi i pozicioneve të punës në këtë subjekt janë miratuar me dokumentet e mëposhtëm:

¹⁵ Ligji nr. 79/2017 “Për sportin”, Neni 47

- Për vitin 2019 me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.247, datë 17.09.2019;
- Për vitin 2020 me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.51, datë 14.02.2020;
- Për vitin 2021 me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.37, datë 25.02.2021.

Struktura përgjegjëse që merret me zhvillimin e sportit në tërësi pranë Bashkisë Pogradec është “Klubi Shumësportësh”, i cili është ngritur para vitit 2019 dhe funksionon si institucion varësie i Bashkisë Pogradec. “Klubi Shumësportësh”, i cili përfshin disiplinat e Futbollit, Volejbollit dhe sportet e tjera. për të tre vitet ka funksionuar dhe funksionon në organikë me 8 punonjës nga të cilët:

1 (një) Drejtor,
 1 (një) përgjegjës i degës ekonomike,
 1 (një) specialist që merret me aktivitetet/marrëdhëniet me median & publikun,
 1 (një) përgjegjës për arsimin e mesëm,
 1 (një) magazinier dhe
 3 (tre) punëtor shërbimi.

Siç vihet re edhe në këtë institucion varësie të Bashkisë Pogradec, nuk është ngritur dhe nuk funksionon si strukturë e posaçmenjë njësi që merret me menaxhimin e terreneve, objekteve dhe ambienteve sportive. Gjithashtu në përbërjen e saj nuk ka të përfshirë burime njerëzore (specialist) që të merren me çështjet e sportit në tërësi dhe menaxhimin e terreneve sportive në veçanti.

Në vitin 2020 nga “Klubi Shumësportësh” u shkëput vetëm sporti i Futbollit duke krijuar një Shoqëri Aksionere (sh. a). Konkretisht, me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.28, datë 01.03.2019 është themeluar shoqëria aksionare Pogradeci F.K, e cila është miratuar me VKB nr.29, 01.03.2019. Kjo shoqëri ka për objekt të veprimtarisë: Organizimin e aktiviteteve në fushën e sportit të futbollit dhe pjesëmarrjen në garat sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit si dhe nga UEFA dhe nuk ka për objekt menaxhimin e terreneve sportive.

Bashkia Prrenjas:

Për periudhën objekt auditimi 2019-2021, organika dhe organizimi i pozicioneve të punës në këtë subjekt janë miratuar me dokumentet e mëposhtëm:

- Për vitin 2019, me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.165, datë 15.08.2019;
- Për vitin 2020 me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Nr.5, datë 10.02.2020;
- Për vitin 2021 me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Nr.19, datë 19.25.2021.

Për vitin 2019 në strukturën e aparatit të Bashkisë Prrenjas është ngritur dhe funksionon Sektori i Arsimit dhe Sportit me organikë 2 (dy) punonjës,

1 (një) përgjegjës sektori
 1 (një) specialist për arsimin.

Ndërsa për vitet 2020 dhe 2021 është ngritur dhe funksionon Sektori i Arsimit, Sportit, Rinisë Turizmit dhe Kulturës, me organikë 2 punonjës,

1 (një) përgjegjës sektori
 1 (një) specialist për rininë dhe turizmin.

Bashkia Librazhd

Për periudhën objekt auditimi 2019-2021, organika dhe organizimi i pozicioneve të punës në këtë subjekt janë miratuar me dokumentet e mëposhtëm:

- Për vitin 2019 me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.03, datë.03.01.2019;
- Për vitin 2020 me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.168, datë 31.12.2019;
- Për vitin 2021 me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Nr.1033, datë 31.12.2020.

Për vitin 2019 dhe vitin 2020 në strukturën e aparatit të Bashkisë Librazhd është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Sporteve dhe brenda kësaj drejtorie funksionon sektori i kulturës dhe aktiviteteve që merret me zhvillimin e sporti në tërësi. Ky sektor nuk ka në organikë specialistë për sportin dhe në veçanti specialistë për menaxhimin e terreneve, objekteve dhe pajisjeve sportive. Por brenda strukturës së këtij sektori është ngritur dhe funksionon Klubi i Futbollit “Sopoti” me përbërje 1 (një) sekretar i klubit të futbollit me arsim të mesëm dhe 2 (dy) punëtorë fushe po me arsim të mesëm. Në vitin 2021 në Drejtorinë e Arsimit, Kulturës dhe Sporteve është shtuar Sektori i Turizmit duke e ndryshuar edhe emërtimin në “Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Turizmit” dhe është hequr nga struktura dhe organika Klubi të Futbollit “Sopoti” që kishte në përbërje 3 punonjës. Me këto ndryshime janë hequr edhe të vetmit punonjës që mund të merreshin me menaxhimin dhe mirëmbajtje të fushave të futbollit.

Në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë Librazhd, miratuar me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.20, datë 28.12.2020 janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Arsimit, Kulturës dhe Sporteve në tërësi si dhe në veçanti në pikën 24, të nenit 57 është përcaktuar se një nga detyrat e kësaj drejtorie është edhe: “Krijimi dhe administrimi i infrastrukturës sportive cilësore, të përshtatshme për të gjitha sportet”. Edhe pse shprehur qartë në këtë rregullore detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj drejtorie në lidhje me administrimin e infrastrukturës sportive, në strukturën e kësaj drejtorie nuk është ngritur sektor i veçantë apo të jenë parashikuar në organikë specialistë të mirëfilltë për sportin dhe në veçanti specialistë për menaxhimin e terreneve sportive.

Bashkia Kurbini:

Për periudhën objekt auditimi 2019-2021, organika dhe organizimi i pozicioneve të punës në këtë subjekt janë miratuar me dokumentet e mëposhtëm:

- Për vitin 2019, me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Nr.18, datë 11.01.2019.;
- Për vitin 2020, me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Nr.9, datë 20.01.2020;
- Për vitin 2021, me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Nr.5, datë 05.01.2021.

Për të tre vitet në strukturën e aparatit të Bashkisë Kurbini është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe brenda kësaj drejtorie funksionon Sektori i Sporteve dhe Aktiviteteve Sportive.

Për vitin 2019, ky sektor ka pasur në organikë me 6 punonjës, nga të cilët:

1 (një) përgjegjës sektori, me arsim të lartë
 3 (tre) inspektorë me arsim të lartë
 2 (dy) inspektorë me arsim të mesëm
 Skuadra e Punëtorëve të Terreneve Sportive me 10 punonjës nga të cilët:
 1 (një) përgjegjës sektori me arsim të lartë
 9 (nëntë) punonjës me arsim të mesëm.

Për vitet 2020 dhe 2021, Sektori i Sporteve dhe Aktiviteteve Sportive ka funksionuar me organike 10 punonjës, nga të cilët:

1 (një) përgjegjës sektori me arsim të lartë
 7 inspektorë me arsim të lartë
 2 inspektor me arsim të mesëm

Skuadra e Punëtorëve të Terreneve Sportive me 10 punonjës nga të cilët:

1 (një) përgjegjës sektori me arsim të lartë

9 punëtorë me arsim të mesëm.

Vlen të vlerësohet puna e mirë e kësaj bashkie pasi, ndryshe nga tre njësitë vendore të mësipërme, ka ngritur dhe ka në funksionon strukturë të posaçme për zhvillimin e sportit në tërësi dhe për menaxhimin e terreneve, objekteve dhe ambienteve sportive.

Gjetje nga auditimi

7. Nga katër bashkitë subjekt i auditimit, nuk janë hartuar dokumente politike, strategji ose plane veprimi vendore për zhvillimin e sportit në tërësi dhe menaxhimin e infrastrukturës sportive në veçanti si përcaktohen në aktet ligjore që rregullojnë funksionimin dhe organizimin e sportit¹⁶.
8. Gjatë tre viteve 2018-2021, në strukturën e Bashkive Pogradec, Prrenjas dhe Librazhd nuk është ngritur dhe nuk funksionon një strukturë e posaçme për sportin në tërësi dhe në veçanti për menaxhimin e terreneve sportive, si përcaktohen në aktet ligjore që rregullojnë funksionimin dhe organizimin e sportit.
9. Në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë Kurbin¹⁷, janë përfshirë detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e Sektorit të Sporteve dhe Aktiviteteve Sportive në tërësi si dhe në veçanti, është përcaktuar se, ky sektor është përgjegjës për: administrimin e aseteve të sportit apo strukturave të tjera që i shërbejnë zhvillimit të stadioneve, fushave të sportit, promovimit të sportit në territorin e bashkisë, administrimin e burimeve materiale, strukturave sportive në pronësi të bashkisë përshtatur në formë organizimi autonome.¹⁸ Por në këtë rregullore nuk janë përfshirë detyrat, kompetenca, përgjegjësitë dhe përkrahjet e punës të Sektorit të Punëtorëve të Terreneve Sportive.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 31-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Konkluzione

6. Mungesa e hartimit të dokumenteve politike, strategjive, planeve vendore të veprimit, cenon zhvillimin e sportit, i cili në Republikën e Shqipërisë është një veprimtari me interes publik.¹⁹
7. Mungesa e një strukture të veçantë që të merret me sportin në tërësi dhe menaxhimin e terreneve sportive në veçanti, tregon qartë se puna e Bashkive Pogradec, Prrenjas dhe Librazhd gjatë periudhës objekt auditimi, nuk ka qenë mjaftueshëm efektive në lidhje me menaxhimin e ambienteve, terreneve dhe objekteve sportive që ka në juridiksionin e saj.
8. Mospërcaktimi qartë dhe në mënyrë shteruese i detyrave, përgjegjësi, kompetencave dhe përkrahjeve të punës, mund të çojë përmbushjen me sukses të objektivave.

Rekomandime

- 7.1 Bashkitë Pogradec, Kurbin, Librazhd dhe Prrenjas, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe institucione të tjera të specializuara për sportin, të ngrenë grupet e punës për hartimin e dokumentit strategjik për sportin në tërësi, pjesë e të cilit të jëtë edhe menaxhimi i infrastrukturës sportive.

Brenda vitit 2022

- 8.1 Bashkitë Pogradec, Prrenjas dhe Librazhd të marrin masa për ngritjen e një strukture të veçantë për sportin në tërësi, pjesë e së cilës të jenë specialistë për menaxhimin e terreneve sportive.

¹⁶ Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” (i ndryshuar), Neni 8 pika 3.

¹⁷ Urdhri i Kryetarit të Bashkisë nr.7, datë 24.11.2016

¹⁸ Pika 12 dhe 13 e nenit 94 të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë Kurbin

¹⁹ Ligji 105/2020 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin”, Neni 2.

8.2 Bashkitë Pogradec, Prrenjas dhe Librazhd, pas ngritjes së strukturës për sportin, të përditësojnë Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit duke përcaktuar në mënyrë shteruese detyrat, kompetencat, përgjegjësitë dhe përshkrimet e punës së strukturave dhe punonjësve të sportit në tërësi dhe në veçanti, detyrat dhe përgjegjësitë e sektorit apo të specialistit të menaxhimit të terreneve sportive.

9.1 Bashkia Kurbin, të përditësojë Rregulloren e Brendshme të Bashkisë, të miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.7, datë 24.11.2016, duke përcaktuar në mënyrë shteruese: detyrat, kompetencat, përgjegjësitë dhe përshkrimet e të punës së Sektorit (skuadrës) së Punëtorëve të Terreneve Sportive.

4.3 A është garantuar menaxhim efektiv i terreneve sportive nëpërmjet fondeve në nivel qendror dhe lokal ?

4.3.1 A ka qenë e mjaftueshme mbështetja financiare nga fondet buxhetore për ofrimin e logjistikës dhe infrastrukturës së duhur për terrenet sportive ?

A ka qenë e mjaftueshme mbështetja financiare nga fondet buxhetore për ofrimin e logjistikës dhe infrastrukturës së duhur për terrenet sportive ?

Për një gjykim sa më profesional në lidhje me performancën e “ *Menaxhimit efektiv i terreneve sportive nëpërmjet fondeve në nivel qendror dhe lokal*”, auditimi u mbështet kryesisht në të dhënat e grumbulluara në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit , dhe nga strukturat që mbulonin sportin si në Bashkitë Librazhd, Prrenjas, Pogradec, Kurbin si dhe në përgjigjet të pyetësorëve përkatës, intervistave të zhvilluara me personat përgjegjës në strukturat e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe të Bashkive përkatëse që mbulonin financën, buxhetin, dhe të menaxhimit financiar dhe kontrollit për sa i përket aktiviteteve sportive në veçanti financimi i terreneve sportive.

Sporti në vendin tonë është një veprimtari me interes publik, ku shteti nxit zhvillimin si të sportit shkollor, elitari dhe gjithashtu duke mbështetur pjesëmarrjen e shtetasve në sport nëpërmjet krijimit të kushteve ligjore , financiare dhe të infrastrukturës sportive, etj.

Në Ligjin Nr. 79/2017, datë 27.04.2017 “Për sportin”, i ndryshuar në nenin 8, citohet që përgjegjëse për zhvillimin e sportit janë Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore:

- ✓ Ministria përgjegjëse për sportin administron fondet buxhetore për sportin dhe kontrollon përdorimin e tyre nga organizatat sportive.
- ✓ Ministria përgjegjëse për sportin bashkëpunon me to për zhvillimin e sportit në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar pavarësinë e funksionimit të tyre, administron objektet sportive publike, që ka në juridiksion, dhe financon ndërtimin e mirëmbajtjen e mjediseve sportive.
- ✓ Njësia administrative e pushtetit vendor harton dhe garanton politikat vendore në fushën e sportit shkollor, sportit për të gjithë dhe sportit elitari, krijon institucione përgjegjëse për sportin, menaxhon objektet sportive, që ka në pronësi, ndërton objekte të reja, sipas nevojës, mbështet zhvillimin dhe veprimtarinë e organizatave sportive që zhvillojnë veprimtari në territoret e tyre.

Në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015. “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 25, Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese, citohet se : Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

- ✓ Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve

Në VKM Nr. 42, datë 25.1.2017 “Për miratimin e planit kombëtar për integrimin evropian 2017–2020”, parashikohet sa vijon:

Ligji Nr.115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV) janë përgjegjëse për zbatimin e një pjesë të madhe të legjislacionit të përafuar me *acquis* të BE-së, që përfshin fusha të rëndësishme si:

- infrastruktura dhe shërbimet publike lokale;
- shërbimet kulturore dhe sportive;
- arsimi parashkollor dhe parauniversitar

Referuar raporteve të monitorimit të përgatitura nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për periudhën 2019-2021, fondet e akorduara për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të ndara veçmas Investimet në total dhe investimet për sportin. Referuar Raporteve të monitorimit të DBMF, investimet sipas programit buxhetor për sportin paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela 8: Investimet sipas programit buxhetor për sportin

Në lekë

Ministria e Arsimit dhe Sportit	2019		2020		2021	
	Plan i rishikuar + të ardhurat	Realizimi i fondeve ku janë përfshirë dhe të ardhurat	Plan i rishikuar + të ardhurat	Realizimi i fondeve ku janë përfshirë dhe të ardhurat	Plan i rishikuar + të ardhurat	Realizimi i fondeve ku janë përfshirë dhe të ardhurat
Totali i fondeve me burim financimi nga buxheti i shtetit + të ardhurat, si dhe donacionet;	44,732,847	42,971,701	44,588,439	42,221,371	46,704,740	44,238,971
Nga të cilat për:						
Fonde për Investime (Financime nga buxheti i shtetit + të ardhurat, si dhe donacionet);	4,672,245	4,405,985	3,980,234	3,734,597	2,758,384	1,812,389
Fonde për Investime në Programin e Sportit	250,000	249,764	30,200	14,120	300,000	295,189
Fondet për Investime për Sportin në % kundrejt totalit të investimeve;	5,3%	5,7%	0,8%	0,4%	11%	16,3%

Burimi i të dhënave: MAS (raportet e monitorimit).

Përpunuar: Grupi i Auditimit.

Nëpërmjet programit buxhetor për Zhvillimin e Sportit nga ana e Ministria e Arsimit dhe Sportit **synimet janë:**

Sigurimi dhe mbrojtja e të drejtave të shtetasve, që merren me edukim fizik dhe sport, në përputhje me Kartën Evropiane të Sportit dhe me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në këtë fushë zbatimin dhe përmirësimin e politikave shtetërore për sportin Elitar dhe sportin në institucionet arsimore në drejtimin organizativ, teknik dhe funksional, qendror dhe lokal.

Krijimin e shanseve të barabarta dhe kushteve për pjesëmarrjen në aktivitete sportive të të gjithë

shtetasve shqiptar mbështetur në të drejtat e njeriut për të ushtruar aktivitet fizik e sportiv, duke krijuar infrastrukturën e duhur ligjore, financiare dhe fizike, rregullimin e marrëdhënieve shtet-institucione sportive.

Siguron shërbim cilësor në sistemin arsimor para universitar dhe atë universitar, duke qenë se sporti është pjesë përbërëse e programit të edukimit të nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore publike dhe jopublike.

Fondet e sportit për investime të realizuara janë:
për vitin 2019 në shumën prej 249, 764 mijë lekë
për vitin 2020 në shumën 14,120 mijë lekë
për vitin 2021 në shumën 295, 189 mijë lekë

Referuar të dhënave të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar rezulton se nga 61 bashki në rang kombëtar janë dërguar kërkesat për investime të arsimit para universitar për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve në vitin 2018 për 28.630 nxënës të arsimit parauniversitar gjithsej 110 kërkesa në vlerë totale projektesh për (palestra dhe terrene sportive dhe rikonstruksione shkollash) në shumën prej 7,985,140,579 lekë, nga të cilat u aprovuan vetëm 12 kërkesa në vlerë projekti 99,053,495 lekë, lekë sipas Vendimit nr.7, datë 11.05.2018 të Komitetit të zhvillimit të Rajoneve referuar listës nr.1 bashkëlidhur.

Nga të dhënat rezulton se pesha specifike e shpenzimeve faktike për investimet në sport në raport me totalin e shpenzimeve për periudhën objekt auditimi janë:

për vitin 2019 5.7% të totalit të shpenzimeve për investime
për vitin 2020 0.4% të totalit të shpenzimeve për investime
për vitin 2021 16,3% të totalit të shpenzimeve për investime

Nga auditimi rezulton se për periudhën objekt auditimi se fondet për investime për terrene sportive për vitin 2019, viti 2020 dhe vitin 2021 nuk janë parashikuar nga buxheti i MAS.

Referuar të dhënave të raporteve të monitorimit vjetore të përgatitura nga Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar në MAS rezulton se:

- Për vitin 2019 buxheti i sportit i realizuar është 448,7 milion lekë dhe zë rreth 0,003% të GDP ose 0.009 % ndaj shpenzimeve publike.
- Për vitin 2020, buxheti i sportit i realizuar është 209,3 milion lekë dhe zë rreth 0,001 ndaj GDP ose rreth 0.009 ndaj shpenzimeve publike.
- Për vitin 2021, buxheti i sportit i realizuar është 1,1 miliard lekë ose 0,007 % ndaj GDP ose 0,019% ndaj shpenzimeve publike.

Referuar të dhënave të raporteve nga Ministria e Arsimit dhe Sportit mbi financimin e terreneve sportive rezulton se janë akorduar fonde buxhetore për NJVQV nëpërmjet Vendimit të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve Nr.7, datë 11.05.2018. (Shih tabelën Nr. 2, Faqe 15)

Për auditimin e menaxhimit të terreneve sportive në NJVV, grupi i auditimit ka marrë dhe shqyrtuar të dhëna nga subjektet e audituara mbi buxhetet e planifikuara dhe realizimet e tyre duke evidentuar ato programe buxhetore që lidhen kryesisht dhe drejtpërdrejtë me çështjet e sportit.

Fondet e akorduara sipas Bashkive/ struktura e sportit, sipas ligjit vjetor të buxhetit (transfertat, dhe të trashëguara dhe nga të ardhurat), si dhe të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak paraqiten si mëposhtëm vijon:

Bashkia Pogradec

Tabela 9: Të ardhurat e planifikuara dhe të realizuara të buxhetit për periudhën 2019-2021 plan/fakt
Në lekë

N r	Emërtimi	2019		2020		2021	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Buxheti i Bashkisë - Total	934,969,673	828,133,443	1,007,166,016	836,757,812	1,225,770,849	979,148,249
2	Buxheti i Sportit	33,835,400	25,730,533	40,737,400	12,169,790	20,166,100	34,288,529
3	FK Pogradecit sh.a			21,540,119		28,310,150	22,875,107
4	Granti specifik						
5	Të ardhura të trashëguara	350,000	86,600	350,000	25,400	350,000	300,000

Burimi: Bashkia Pogradec,
Përpunoi: Grupi i Auditimit

Fondet e planifikuara për sportin zënë për vitin 2019 rreth 3,6% të totalit të fondeve të bashkisë, për vitin 2020 zë rreth 4% të totalit të fondeve të bashkisë dhe për vitin 2021 zë rreth 1,6% të totalit të fondeve të bashkisë.

Tabela 10: Fondet e planifikuara për shpenzime për Bashkinë Pogradec/Struktura për sportin për vitet 2019 – 2021(Në lekë)

Institucioni	Shpenzimet	2019		2020		2021	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Bashkia Pogradec	Totali i fondeve të shpenzimit	216,209,410	211,034,484	166,010,400	51,858,540	209,263,128	156,931,498
	Totali i fondeve të shpenzimit	362,375,760	353,383,341	389,976,605	319,735,440	489,132,000	405,671,778
Struktura e sportit	Totali i fondeve të shpenzimit	1,060,000	1,060,000	1,967,800	1,013,400	2,954,200	1,454,400
	Totali i fondeve të shpenzimit	32,775,400	24,247,564	17,564,636	10,534,490	45,521,850	34,288,529

Burimi: Bashkia Pogradec,
Përpunoi: Grupi i Auditimit

Buxheti i Bashkisë Pogradec për periudhën objekt auditimi është miratuar: për vitin 2019, me VKB nr.2, datë 04.01.2019, për vitin 2020 me VKB nr.115, datë 27.12.2020 për vitin 2021 me VKB nr.144, datë 24.12.2020.

Buxheti i FK Pogradeci është miratuar me VKB nr.19, datë 28.01.2020.

Rezulton se nuk ka fonde të planikuara për investime për sportin nga Bashkia Pogradec për vitin 2019 dhe 2020 për ndërtime për terrenet sportive, janë kryer vetëm investime për riparime ndërtesa, stadiumi. Për vitin 2021, investime për sportin(për FK Pogradeci sha) rezultojnë të realizuara në shumën prej 22,875,107 lekë ose 81% të fondeve të planifikuara për sportin dhe janë përdorur kryesisht për riparim tarrace, ndërtesa stadium, mbikqyrje dhe kolaudim punimesh dhe jo për ngritje terrene sportive për sistemin arsimor parauniversitar dhe për komunitetin në pronat publike të bashkisë.

Bashkia Prrenjas

Tabela 11: Të ardhurat e planifikuara dhe të realizuara të buxhetit për periudhën 2019-2021 plan/fakt(Në lekë)

Nr	Emërtimi	2019		2020		2021	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Buxheti i Bashkisë - Total	400,784,346	268,356,670	468,490,772	344,269,294	499,078,916	396,960,918
2	Buxheti i Sportit			1,500,000		1,500,000	-
3	Të ardhura të trashëguara	56,650,000	55,503,868	60,000,000	65,704,176	80,070,000	80,506,590

Burimi: Bashkia Prrrenjas,
Përpunoi: Grupi i Auditimit

Tabela 12: Fondet e planifikuara për shpenzime për Bashkinë Prrrenjas/Struktura për sportin për vitet 2019 – 2021

Në lekë

Institucioni	Shpenzimet	2019		2020		2021	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Bashkia Prrrenjas	Totali i fondeve të shpenzimeve	98,181,091	47,708,786	164,947,153	89,117,834	178,274,000	120,254,851
	Totali i fondeve të shpenzimeve	302,603,255	220,647,884	316,851,837	255,151,460	320,804,916	276,706,059
Struktura e sportit	Totali i fondeve të shpenzimeve	0	0	0	0	0	0
	Totali i fondeve të shpenzimeve	0	0	1,500,000	0	1,500,000	0

Burimi: Bashkia Prrrenjas,
Përpunoi: Grupi i Auditimit

Buxheti i Bashkisë Prrrenjas për periudhën objekt auditimi është miratuar:

për vitin 2019 me VKB nr.25, datë 05.04.2019
për vitin 2020 me VKB nr.14, datë 20.12.2019
për vitin 2021 me VKB nr.107, datë 30.12.2020

Për periudhën objekt auditimi, nga ky subjekt nuk rezulton të jenë kryer investime për sportin (terrenet sportive).

Bashkia Prrrenjas, gjatë vitit 2019 me fondet e akorduara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në shumën prej 99,053,495lekësh, ka zhvilluar procedurën e prokurimit “Ndërtim i fushës së re të sportit, qyteti Prrrenjas”, procedurë e cila është anuluar nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Sipas Vendimit KPP me nr. 217/2019 i datës 15.04.2019, në zbatim të nenit 24 pika 1 gërma “dh” të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, anuloi procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt” Ndërtimi i fushës së re të sportit, qyteti Prrrenjas”, me nr. REF-89975-10-15-2018, me fond limit 82,544,578 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 23.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Prrrenjas.

Për shkeljet e konstatuara në këtë procedurë prokurimi, i gjithë dokumentacioni për objektin e prokurimit “ Ndërtimi i fushës së re të sportit, qyteti Prrrenjas ”, është sekuestruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan me Vendim Sekuestrimi dt.13.02.2019 për procedimin penal nr.303 të vitit

2019 për procedurën e prokurimit “Ndërtim i fushës së re të sportit, qyteti Prrrenjas”.

Bashkia Librazhd

Buxheti i Bashkisë Librazhd për periudhën objekt auditimi është miratuar:

për vitin 2019 me VKB nr.2138, datë 24.12.2018

për vitin 2020 me VKB nr.149, datë 30.12.2019

për vitin 2021 me VKB nr.120, datë 29.12.2020

Tabela 13: Të ardhurat e planifikuara dhe të realizuara të buxhetit për periudhën 2019-2021 plan/fakt
Në Lekë

Nr	Emërtimi	2019		2020		2021	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Buxheti i Bashkisë -Total	1,330,221,285	1,185,040,285	1,427,714,145	1,269,913,233	1,400,833,946	1,254,932,856
2	Buxheti i Sportit	102,480,182	102,415,109	12,685,000	12,685,000	12,000,000	12,000,000
3	Granti specifik i vitit	941,582,103	881,890,044	1,136,026,145	1,072,977,810	1,105,449,569	1,046,042,448
4	Të ardhura të veta e të trashëguara	286,159,000	200,735,000	279,003,000	184,250,423	283,384,377	196,890,408

Burimi: Bashkia Librazhd,

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Buxheti i Bashkisë Librazhd për vitin 2019, është miratuar me VKB nr.2138, datë 24.12.2018, për vitin 2020 me VKB nr.149, datë 30.12.2019 dhe për vitin 2021 me VKB nr.120, datë 29.12.2020.

Referuar të dhënave rezulton se fondet buxhetore të planifikuara për strukturën e sportit për vitin 2019 zënë rreth 7.7% të fondeve totale për bashkinë, për vitin 2020 zënë rreth 0,9% të fondeve totale për bashkinë dhe për vitin 2021 0,85% të fondeve totale për bashkinë.

Tabela 14: Fondet e planifikuara për shpenzime për Bashkinë Librazhd/Struktura për sportin për vitet 2019 – 2021

Në lekë

Institucioni	Shpenzimet	2019		2020		2021	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Bashkia	Totali i fondeve i shpenzimeve kapitale	392,250,792	305,966,691	402,531,894	317,871,785	291,080,553	242,959,525
	Totali i fondeve të shpenzimeve të bashkisë	1,330,221,285	1,185,040,153	1,427,714,145	1,269,913,233	1,400,833,946	1,254,932,856
Struktura e sportit	Totali i fondeve i shpenzimeve kapitale	91,120,982	91,120,982	–	–	–	–

	Totali i fondeve të shpenzimeve të strukturës për sportin	102,480,182	102,415,109	12,685,000		12,000,000	12,000,000
--	---	-------------	-------------	------------	--	------------	------------

Burimi: Bashkia Librazhd,

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Fondet për investime për sportin janë parashikuar vetëm për vitin 2019 të cilat janë realizuar në shumën prej 91,120,982 lekë, ose 100% të fondeve të planifikuara.

Fondet për investime për sportin zënë rreth 23,2% të totalit të fondeve për investime të bashkisë për vitin 2019. Për vitin 2020 dhe 2021 nga ana e Bashkisë nuk janë planifikuar fonde për investime për sportin (terrenet sportive) dhe rrjedhimisht nuk ka as realizim të tij.

Gjatë vitit 2018 e 2019 me fondet e Bashkisë Librazhd, në bazë të kontratës me nr.7239 prot datë 23.11.2018 me subjektin “ Ergi” shpk është rikonstruktuar hapësira publike multifunksionale në vlerë 7,192,246 lekë dhe rehabilitimi urban i zonës përreth fushës së sportit në vlerë 1,080,096 lekë (vetëm për terrene sportive).

Bashkia Kurbin

Tabela 15: Të ardhurat e planifikuara dhe të realizuara të buxhetit për periudhën 2019-2021 plan/fakt

Në lekë

Nr.	Emërtimi	2019		2020		2021	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Buxheti i Bashkisë -Total	536,803,226	433,511,248	574,472,788	413,224,811	648,320,391	509,573,239
2	Buxheti i Sportit	41,711,296	40,164,267	27,081,270	26,122,276	26,281,270	26,281,270
3	Granti specifik i vitit	16,008,896	16,008,896	----	-----	-----	-----
4	Të ardhura të veta të trashëguara	25,702,400	24,155,371	27,081,270	26,122,276	26,281,270	26,281,270

Burimi: Bashkia Kurbin,

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Buxheti i Bashkisë Kurbin për vitin 2019, është miratuar me VKB nr.171, datë 12.12.2018, për vitin 2020 me VKB nr.58, datë 27.12.2019 dhe për vitin 2021 me VKB nr.156, datë 14.12.2020.

Referuar të dhënave rezulton se fondet buxhetore të planifikuara për strukturën e sportit për vitin 2019 zënë rreth 7,7% të fondeve totale për bashkinë, për vitin 2020 zënë rreth.4,7% të fondeve totale për bashkinë dhe për vitin 2021 zënë 4% % të fondeve totale për bashkinë.

Fondet e planifikuara për shpenzime për Bashkinë/ Kurbin dhe struktura për sportin për vitet 2019 – 2021, paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela 16: Fondet e planifikuara për shpenzime për Bashkinë Kurbin/Struktura për sportin për vitet 2019 – 2021

Në lekë

Institucio ni	Shpenzime t	2019		2020		2021	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Bashkia	Totali i fondeve i shpenzimeve kapitale	98,548,855	60,296,907	94,137,621	10,837,520	172,773,859	96,448,354
	Totali i fondeve të shpenzimeve të bashkisë	536,803,226	433,511,248	574,472,788	413,224,811	648,320,391	509,573,239
Struktura e sportit	Totali i fondeve i shpenzimeve kapitale	16,008,896	16,008,896	-----	-----	-----	-----
	Totali i fondeve të shpenzimeve të strukturës për sportin	41,711,296	40,164,267	27,081,280	26,122,276	26,281,270	26,281,270

Burimi: Bashkia Kurbin,

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Fondet për investime për sportin janë parashikuar vetëm për vitin 2019 të cilat janë realizuar në shumën prej 91,120,982 lekë, ose 100% të fondeve të planifikuara.

Fondet për investime për sportin zënë rreth 23,2% të totalit të fondeve për investime të bashkisë për vitin 2019.

Terreni Sportiv në Shkollën Nr. 1 “Mark Trokthi” Laç i ndërtuar me bashkëfinancim të MAS dhe të Bashkisë Kurbin rezulton se është një ambjenti multisportiv me sipërfaqe 2600 m².

Dy fusha të rrethuara me rrjeta të plastifikuara, plus ambjente ndihmëse dushe, dhoma zhveshje etj, të cilat janë:

Fusha e Futbollit (Kalçeto) është me përmasa 30m² X 60m²

Fusha e Basketbollit / Volejbollit është me përmasa 15m² X 25 m²

Terreni sportiv i shkollës nr. 1 “Mark Trokthi” frekuentohet normalisht nga nxënësit e shkollës që janë 290, nga të cilët 158 nxënës janë të arsimit 9- vjeçar dhe 132 janë të arsimit fillor.

Duke qënë shkollë qendër komunitare, terreni sportiv frekuentohet nga moshat e reja dhe të rritura, kryesisht të lagjes nr. 2 e cila është një ndër lagjet më të populluara të qytetit Laç, por edhe nga komuniteti i qytetit në përgjithësi.

Gjithashtu, terreni sportiv frekuentohet rregullisht edhe nga tre ekipe futbollit të kategorisë superiore U₁₁, U₁₃, dhe U₁₅ rreth 50 nxënës.

Frekuentimi i terrenit sportiv, paradite nga 290 nxënës të shkollës, pasdite nga mbi 100 frekuentues me aktivitete të ndryshme sportive mes shkollash dhe ekipesh sportive, si dhe frekuentues nga komuniteti tregojnë dhe pasqyrojnë efektivitetin e tij.

Në kuadër të procesit të rindërtimit në Bashkinë Kurbin janë rindërtuar ose rikonstruktuar edhe disa institucione arsimore nga të cilat janë marrë në dorëzim dy të tilla:

Rindërtim shkolla 9-vjeçare dhe kopështi “Dan Bajrami” “Gjorem me vlerë 131,046,610 lekë së bashku me terrene sportive.

Rikonstrukcion shkolla 9- vjeçare “Migjeni “Mamurras me vlerë 41,371,215 lekë së bashku me terrenet sportive.

Gjetje nga auditimi

10. Për periudhën objekt auditimi, Ministria e Arsimit dhe e Sportit si institucioni përgjegjës për zhvillimin e sportit, nuk ka parashikuar fonde për investime në veçanti në programin “Zhvillimi i sportit dhe i rinisë” për ngritjen, rikonstruksionin e objekteve, ambienteve dhe terreneve sportive në shkolla të sistemit parauniversitar. Mungesa e fondeve buxhetore ka sjellë mosplotësimin e nevojave për 110 kërkesa nga 61 bashki në rang kombëtar, për investime në infrastrukturën shkollore dhe në ngritjen objekteve, ambienteve dhe terreneve sportive.
11. Ministria e Arsimit dhe e Sportit nuk ka hartuar një bazë të dhënash (regjistër manual ose elektronik) në lidhje me inventarin e objekteve, ambienteve dhe terreneve sportive të sistemit arsimor parauniversitar, të ndara sipas disiplinave të sporteve në rang kombëtar. Regjistri duhet të përmbajë informacion për objektet, ambientet dhe terrenet sportive, të ndërtuara apo të rikonstruara me fonde buxhetore nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit, me financime nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, bashkëfinancime apo dhe nga donacione të ndryshme. Po kështu në regjistër duhet të jepet informacion në lidhje me pronësinë e tyre, vitin e krijimit, sipërfaqen, amortizimin dhe vlerën përkatëse të mbetur.
12. Referuar të dhënave nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në lidhje me rikonstruksionin e terreneve sportive në sistemin parauniversitar (palestrave), rezultojnë se, për vitin 2018-2019 janë financuar për rikonstruksion 45 terrene sportive dhe palestra sportive në sistemin arsimor parauniversitar.²⁰ Konstatohet se, terrenet sportive të ngritura apo të rikonstruara me fondet buxhetore të dhëna nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit apo me bashkëfinancim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, nuk janë monitoruar nga pikëpamja e zbatimit të standardeve ndërkombëtare dhe manualeve për ngritjen e infrastrukturës sportive sipas disiplinave të ndryshme të sportit para kryerjes së investimit nga struktura e sportit në Ministrinë e Arsimit dhe e Sportit, si institucion monitorues e kontrollues i përdorimit të këtyre fondeve në zbatim të akteve ligjore që rregullojnë funksionimin dhe organizimin e sportit në Republikën e Shqipërisë.
13. Nga Bashkitë Pogradec, Prrenjas dhe Kurbin, për periudhën objekt auditimi, nuk janë planifikuar fonde për investime për ngritjen e objekteve, ambienteve dhe terreneve sportive për komunitetin apo dhe shkollat e arsimit parauniversitar. Në vitin 2018 nga ana e Bashkisë Pogradec janë dërguar kërkesa për investime për terrene sportive (Rehabilitimi i shkollës së mesme “Muharrem Collaku” me vlerë totale 92,869,910 lekë), të cilat nuk u parashikuan nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe e Sportit. Ndërsa, në Bashkinë Prrenjas, edhe pse janë akorduar fondet nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit në vitin 2018, në vlerën prej 99,053,495 lekë, për ndërtimin e fushës së re të sportit të qytetit, këto fonde nuk u realizuan për shkak të shkeljeve të bëra në procedurën e prokurimit. Për këtë arsye i gjithë dokumentacioni i kësaj procedure është sekuestruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan me Vendim Sekuestrimi të datës 13.02.2019 për procedimin penal nr. 303 të vitit 2019 dhe çështja deri në periudhën e auditimit vazhdon të jetë në hetim apo gjykim.
14. Bashkia Librazhd megjithëse ka hartuar programe për zhvillimin e sportit, nuk ka ngritur një strukturë me specialistë për sportin me qëllim monitorimin dhe realizimin e objektivave të caktuara në programet e zhvillimit. Gjithashtu për vitin 2020 dhe 2021, Ministria e Arsimit dhe e Sportit, pavarësisht kërkesave të bëra nga kjo bashki nuk ka planifikuar fonde për ngritjen e terreneve sportive në prona publike dhe në shkolla. Për vitin 2018, Bashkia ka bërë 3 kërkesa për bashkëfinancim për rikonstruksionin e një shkolle 9-vjeçare në Njësinë Lunik dhe 2 shkolla të mesme në Njësitë Polis dhe Hotolisht nga ku u aprovua vetëm për njësinë Hotolisht rikonstruksion i shkollës së mesme dhe ndërtim palestre si dhe sistem ngrohje shkolle “Rahman Çota”, në vlerën 70, 762,869 lekë nga bashkia, fondi i planifikuar 7,076,287 lekë.

²⁰ Tabela 17: Financimi për rikonstruksion të terreneve sportive për vitet 2019 – 2021(Burimi MAS)

15. Bashkitë Pogradec, Prrenjas dhe Kurbin nuk kanë të evidentuar në kartela të veçanta ambientet dhe terrenet sportive që kanë në pronësi dhe juridiksionin e tyre, duke regjistruar e ndërtimit, investimet e kryera, amortizimin dhe vlerën e mbetur.
- Ndryshe nga 3 njësitë vendore të tjera, nga auditimi i mbajtjes dhe evidentimit të terreneve sportive në Bashkinë Librazhd, rezultoi se inventarizimi i tyre është kryer konform dispozitave ligjore por pasqyrimi në kontabilitet i terreneve nuk është i specifikuar me emërtim sipas disiplinës sportive (pra fushë basketbolli, volejboli apo multifunkionale) në sasi dhe vlerë, dhe vitin e krijimit me qëllim identifikim, ruajtjen dhe administrimin e terreneve sportive.

Konkluzione

9. Mungesa e një strategjie kombëtare për sportin është shoqëruar me mungesë të planifikimit të fondeve buxhetore, ka ndikuar në mosplotësimin e nevojave të NJVQV-ve për të zhvilluar terrenet sportive.
10. Mungesa e hartimit të një regjistri analitik për terrenet sportive, sjell vështirësi në planifikimin dhe shpërndarjen e terreneve të reja sportive dhe ka si pasojë mungesën e bashkëpunimit, monitorimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet bashkive si përfituese të fondeve për investime dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si financuese e fondeve buxhetore, të përcaktuara këto në aktet ligjore që rregullojnë funksionimin dhe organizimin e Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore.²¹
11. Mungesa e monitorimit të përdorimit të fondeve nga pikëpamja e zbatimit të standardeve ndërkombëtare dhe manualeve për ngritjen e infrastrukturës sportive sipas disiplinave të ndryshme të sportit para kryerjes së investimit mund të cenojë përdorimin me efektivitet të fondeve. Mungesa e politikave dhe programe për zhvillimin e sportit, mos ngritja të strukturave që mbulojnë sportin në tërësi apo specialistit që të merren me menaxhimin e terreneve sportive, kanë sjellë mos planifikim të fondeve për investime zhvillimin e sportit dhe për menaxhimin e terreneve sportive si për nxënësit dhe të rinjtë ashtu edhe për komunitetin.
12. Vlen të përmendet shembulli pozitiv i Bashkisë Kurbin, e cila në ndryshim nga bashkitë e tjera, ka të ngritur strukturën e sportit dhe menaxhimit të terreneve sportive.

Rekomandime

- 10.1 Ministria e Arsimit dhe Sportit, gjatë hartimit të projekt-buxhetit për vitet në vazhdim, të mundësojë parashikimin me fonde për sportin, të mbështetura në politika dhe objektiva të qarta afatgjatë për zhvillimin e tij, duke përfshirë dhe fonde për investime për ngritjen dhe rikonstruksionin e terreneve sportive në të gjithë sistemin arsimor me qëllimin për të ofruar një shërbim arsimor me standarde evropiane.

Në vijimësi

- 11.1 Ministria e Arsimit dhe e Sportit të bashkëpunojë me të gjitha Njësitë Vendore për hartimin e një data baze të objekteve, ambienteve dhe terreneve sportive në nivel kombëtar. Kjo data basë të shoqërohet me një informacion të hollësishëm sipas llojit të disiplinave sportiv, titujt e pronësisë, sipërfaqet, amortizimin, vlerën dhe numrin e nxënësve që i frekuentojnë etj., me qëllim ushtrimin e veprimtarive sportive, veprimtari rekreative, gara sportive, etj, dhe administrimin dhe menaxhimin me eficientë efektivitet dhe ekonomikitet të terreneve.

Brenda vitit 2022

- 12.1 Ministria e Arsimit dhe Sportit, për një menaxhim sa më efektiv të fondeve për investime të destinuar për ngritjen dhe rikonstruksionin e terreneve sportive, të ngrejë grupe pune, të cilët

²¹ Ligjit Nr.135/2015, datë 17.12.2015” Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 10, 11, 12.

para fillimit të investimit në çdo bashki, për ndërtimin e terreneve sportive të disiplinave dhe llojeve sportive të ndryshme, të vlerësojë projekte të mbështetur në standardet ndërkombëtare si edhe të monitorojë përdorimin e fondeve të dhëna nga ana e NJVQV-ve.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.1 Bashkitë Pogradec, Prrenjas, Librazhd dhe Kurbin të hartojnë politika të mbështetura në objektiva afatgjatë për zhvillim e sportit dhe gjatë hartimit të projekt-buxhetit të planifikojnë fonde për investime kryesisht në ndërtimin e palestrave, fushave sportive si basketbolli, volejboli etj., duke i shërbyer nxënësve kryesisht, rinisë dhe komunitetit në përgjithësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.1 Bashkia Librazhd të marrë masa për ngritjen e një strukturë të dedikuar për sportin me synim zhvillimin e sportit në tërësi dhe planifikimin e nevojave për terrene sportive të disiplinave të ndryshme në funksion të komunitetit.

Mars 2023

15.1 Bashkitë Pogradec, Prrenjas dhe Kurbin, për një menaxhimin me efikasitet dhe efektivitet të objekteve, ambienteve dhe terreneve sportive që kanë në pronësi dhe në juridiksionin e tyre, duhet të hapin dhe të mbajnë kartela të veçanta për të gjitha këto prona duke regjistruar, vitin i ndërtimit, investimet e kryera, amortizimin dhe vlerën e mbetur.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.2 Bashkia Librazhd, të pasqyrojë në kontabilitet terrenet sportive duke i specifikuar me emërtim sipas disiplinës sportive (pra fushë basketbolli, volejboli apo multifunkionale) në sasi dhe vlerë, dhe vitin e krijimit me qëllim identifikim, ruajtjen dhe administrimin e terreneve sportive.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.3.2 A janë përdorur nga ana e NJVQV burime të tjera të financimit në funksion të terreneve sportive?

Për të vlerësuar nëse Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe 4 (katër) Njësitë e Qeverisjes Vendore që janë objekt të këtij auditimi, kanë qenë efektive në gjetjen burimeve të tjera të financimit nëpërmjet donacioneve apo dhurimeve të ndryshme në natyrë, në funksion të menaxhimit të terreneve sportive, grupi i auditimit përdori kritere, burimi i të cilave ishin:

Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

Ligji nr. 79/2017 “Për sportin”,

Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, dhe nga Drejtoria e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit dhe Sportit dhe nga sektorët e buxheteve dhe të sporteve të 4 Njësive Vendore si dhe nga përgjigjet e intervistave të zhvilluar me stafin e strukturave të këtyre institucioneve që mbulojnë fushën e sportit, me qëllim dhënien e përgjigjeve të kësaj pyetje, rezultoi se:

Gjetje nga auditimi

16. Për periudhën objekt auditimi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk u paraqitën të dhëna në lidhje me financimet e përfituara nëpërmjet donacioneve të ndryshme, si në vlerë dhe në natyrë apo marrëveshje dhe kontrata dhurimi të lidhura në favor të njësive vendore dhe të institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar, në funksion të ngritjes, rikonstruksionit dhe

menaxhimit të terreneve sportive. Në të njëjtën mënyrë, katër NJVQV-të e audituara nuk paraqitën të dhëna se kanë përfituar donacioneve të ndryshme, në vlerë dhe në natyrë apo kanë lidhur marrëveshje e kontrata dhurimi, në funksion të ngritjes, rikonstruksionit dhe menaxhimit e terreneve sportive që kanë në juridiksionin e tyre. Burimet e financimeve për menaxhimin e terreneve sportive për këto njësi vendore kanë qenë kryesisht nga buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si fonde buxhetore të kushtëzuara dhe fondet e përfituara nga të ardhurat e veta. Mungesa e burimeve të financimit nga donatorët e ndryshëm ka ardhur edhe nga mungesa e hartimit të programeve dhe projekteve për ndërtimin e objekteve të reja sportive dhe rikonstruksionin e objekteve ekzistuese si nga struktura e sportit në NJQV dhe nga struktura e sportit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Konkluzione

13. Mungesa e iniciativave për të gjetur mundësi të tjera financimi si në vlerë dhe në natyrë për ngritjen, rikonstruksionin dhe menaxhimin e terreneve sportive nga institucione të ndryshme sportive, donatorë të ndryshëm dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare, si nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ashtu edhe nga NJVQV-të, mund të cenojë arritjen e objektivave për zhvillimin e sportit.

Rekomandime

- 16.1 Ministria e Arsimit dhe Sportit, në cilësinë e institucionit qendror politikëbërës në fushën e sportit, në bashkëpunim me Njësitë Vendore dhe Institucionet e Sportive, të bëjë përpjekje për të gjetur mundësi bashkëpunimi me institucione të ndryshme sportive, me donatorë të ndryshëm dhe me institucionet financiare kombëtare dhe ndërkombëtare për të përfituar donacione në vlerë apo në natyrë, për ndërtimin, rikonstruksionin, mirëmbajtjen e terreneve, objekteve, ambienteve dhe pajisjeve sportive.

Menjëherë dhe në vijimësi

- 16.2 Ministria e Arsimit dhe Sportit të kërkojë nga NJVQV-të, paraqitjen e nevojave për infrastrukturën e nevojshme për terrenet sportive nëpërmjet projekteve ose programeve të hartuara me qëllim.

Menjëherë dhe në vijimësi

- 16.3 NJVQV-të të mos mjaftohen vetëm me burimet e financimit nga buxheti qendror dhe të ardhurat vendore por të vlerësojë mundësinë për gjetjen e burimeve të tjera alternative të financimit nëpërmjet marrëveshjeve ose kontratave me federata apo shoqata sportive ose donatorëve të ndryshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

- 16.4 NJVQV të evidentojnë nevojat për terrene sportive dhe të përgatitin programe ose projekte për ti paraqitur të Ministrisë e Arsimit dhe Sportit dhe institucione të tjera me qëllim përfitimin e fondeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. PËRMBLEDHJE

Objektivi kryesor i këtij auditimi ka qenë vlerësimi i procesit të menaxhimit të terreneve sportive nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Bashkitë Pogradec, Prrenjas, Librazhd dhe Kurbin, për periudhën 2018-2021. Fokusi kryesor i auditimit ka qenë analiza e politikave të hartuara për zhvillimin e sportit në tërësi, strukturat përgjegjëse si edhe mbështetja me fonde buxhetore për ngritjen ose rehabilitimin e terreneve sportive. Në këtë mënyrë është synuar të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv nëse janë përdorur dhe menaxhuar burimet e duhura për identifikimin e nevojave, ngritjen dhe rehabilitimin e terreneve sportive me synim garantimin e të drejtës së shtetasve, që merren me edukim

fizik dhe sport, në përputhje me Kartën Evropiane të Sportit dhe me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në këtë fushë. Me anë të këtij objektivi do të mund të konkludojmë se deri në çfarë mase kanë qenë efektive veprimtaria e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si organ politikë bërës dhe orientues në fushën e sportit nga njëra anë dhe Bashkitë Pogradec, Prrenjas, Librazhd dhe Kurbin nga ana tjetër, subjekte të këtij auditimi me fokus menaxhimin e terreneve sportive. Masat e marra nga institucionet përgjegjëse për hartimin e politikave, ngritjen e strukturave të përshtatshme, si dhe mbështetjen me fonde buxhetore, nuk kanë qenë efektive dhe sporti në përgjithësi nuk ka marrë vëmendjen e duhur si në nivelin qendror ashtu edhe në atë vendor. Krahas mungesës së hartimit dhe zbatimit të politikave shtetërore dhe vendore për sportin, strukturave të përshtatshme, mbështetjes me fonde buxhetore me qëllim zhvillimin e sportit si përcaktohen në Ligjin Nr. 79/2017, datë 27.04.2017 “Për sportin”, i ndryshuar, mungon edhe raporti i bashkëpunimi mes aktorëve të përfshirë në këtë proces.

Gjetjet e këtij auditimi kanë prekur elementë që kanë të bëjnë me zbatimin e kornizës ligjore dhe për këtë është përdorur si kriter kryesisht Ligjin Nr. 79/2017, datë 27.04.2017 “Për sportin”, i ndryshuar. Grupi i auditimit ka gjeneruar gjetje që prekin detyrimin e subjekteve për hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e sportit, ngritjen e strukturave të përshtatshme si edhe mbështetjen e tyre me fonde buxhetore me synim zhvillimin e sportit dhe terreneve sportive.

Krahas tyre janë gjeneruar gjetje lidhur me koordinimin, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacioneve e të dhënave mes institucioneve përgjegjëse.

Për të gjitha gjetjet e mësipërme janë dhënë rekomandime specifike për institucionet përkatëse shoqëruar me afatet kohore se kur duhen realizuar këto rekomandime.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT